21 luftëtarët e UÇK-së por edhe mbarë populli nuk është i  
22 informuar -- nuk ishte i kënaqur me informimin që bëhej në atë  
23 periudhë në televizionin shqiptar, por edhe në disa media të  
24 tjera shqiptare për situatën në zonat e luftës. Thuhej se po  
25 mbrohet pragu i shtëpisë dhe ishte vërejtje me vend, sepse

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 66

1 Ushtria Çlirimtare e Kosovës luftonte për çlirimin e Kosovës e  
2 jo vetëm për mbrojtjen e pragut të shtëpisë.

3 PY. Kur ka ndodhur ky takimi pak a shumë?

4 PË. Nga fundi i prillit ose fillimi i majit i vitit 1998.

5 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do i kërkoja Sekretarit të  
7 Seancës të paraqesë në ekran provën materiale P286 që është  
8 deklarata ose kumtesa politike e UÇK-së Nr. 2. Ndërkohë  
9 përkthimi në anglisht është në dokumentin U016-2145 deri në  
10 U016-2147. Do kërkoj që të paraqitet faqja 2 e transkriptit në  
11 anglisht në ekran që është konkretisht dokumenti që  
12 identifikohet si U016-2146. Ndërkohë që prova materiale 286  
13 është vetëm një faqe.

14 PY. Dëshmitar, e di që është shkruar me shkronja shumë të  
15 vogla në shqip, megjithatë t'jua lexoj unë pjesët përkatëse në  
16 anglisht dhe ju mund ta ndiqni përmes përkthimit, për t'ju  
17 bërë pastaj pyetje.

18 Dëshmitar, data është 29 prill 1998. Në pikën 8 në faqen  
19 e dytë --

20 Z. HALLING: [Përkthim] Pra, shkojmë në fund të faqes tek  
21 anglishtja, tek pika -- një faqe tjetër, ju lutem.

22 PY. Në pikën 8 thuhet --

23 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem, të shkojmë dhe tek  
24 shqipja në mënyrë që të reflektohet.

25 PY. Thuhet:

1 "Mjetet shqiptare të informimit publik i thërrasim për  
2 paraqitje objektive të realitetit në luftë. UÇK-së nuk i  
3 nevojiten reklamimet publike dhe botimet publicistike për  
4 qëllime përftimi por as edhe mohimi dhe deformimi i luftës së  
5 saj."

6 Dëshmitar, pra, nëse është data 29 prill kjo është  
7 për afërsisht në të njëjtën kohë kur keni folur me Rexhep  
8 Selimin të cilin e keni reflektuar në librin tuaj, apo jo?  
9 PË. Me siguri pak më vonë, sepse më 29 prill kam qenë në  
10 Gllogjan të Deçanit, në Dukagjin edhe nuk e kam parë këtë  
11 komunikatë. Aty ka qenë e pamundur se kam qenë fillimisht në  
12 Gjakovë pastaj dhe në Gllogjan.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, desha t'ju  
14 thoja diçka sa i takon provës në fakt. Ky është një provë  
15 materiale e pranuar me numrin P280, por nuk e kuptoj se pse  
16 nuk është pranuar transkripti në gjuhën angleze. Kështu që do  
17 ju luteshim që të pranohej dhe përkthimi në gjuhën angleze që  
18 mban numrin U016-2145 deri U016-2147 dhe ta bashkëngjisim me  
19 numrin e provës materiale.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
21 kundërshtime?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
24 Nuk ka kundërshtime. Materiali me numër U016-2145 deri U016-  
25 2147 pranohet dhe i bashkëngjitet provës materiale P286.

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 68

1 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ju faleminderit. Ju  
2 informoj se është e klasifikuar si konfidenciale.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të riklasifikohet si dokument  
4 publik.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse nuk ka  
6 kundërshtime, dokumenti riklasifikohet si dokument publik.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ju faleminderit.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Sa u takon edhe klasifikimit të  
9 videove që do të shohim më vonë gjatë pyetjeve tona desha t'ju  
10 them që shumica prej tyre janë si të klasifikuara si  
11 konfidenciale. Për pjesët që kemi zgjedhur ne sot, për nga  
12 natyra që kanë ato, mendojmë që nuk janë konfidenciale,  
13 përveçse me përjashtim të rasteve kur do të ketë kundërshtime  
14 sugjerojmë që mund të përcillen këto video si publike.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

16 Z. HALLING: [Përkthim]

17 PY. Dëshmitar, tani do t'ju tregoj një provë tjetër që mban  
18 numrin SPOE00226557 [Sipas përkthimit] - 226613 dhe më  
19 konkretisht faqja SPOE00226545 dhe në shqip dhe në anglisht.  
20 Dhe ky është një bllok shënimesh.

21 Dëshmitar, ndërkohë që presim të shfaqet materiali në  
22 ekran desha t'ju thoja që ju keni përmendur në librin tuaj që  
23 kontaktet e para me UÇK-në i keni pasur me një zotëri që quhet  
24 Shaban Hoxha, kështu?

25 Dhe përgjigjet duhet t'i jepni me zë për procesverbal.

1 PË. Po, me Shaban Hoxhën jam takuar në Prishtinë, sepse kam  
2 pas informacion se ai është anëtar i ekipit të këshillit të  
3 emergjencës dhe ka ndihmuar shumë me ndihma për popullatën  
4 civile në zonat e luftës.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Në rregull. Shohim edhe një herë  
6 librin SPOE00226545. Shoh që është faqja 19 në shqip, në  
7 ekran.

8 Në fund të këtij shënimi, në gjuhën shqipe, ka një shënim  
9 tek shqipja; anglisht -- ju lutem më poshtë tek shqipja, se  
10 anglishtja është në rregull. Më poshtë në fund të faqes këtu.

11 PY. Dëshmitar, ka një shënim këtu te ky blloku i shënimeve  
12 18.05.98 është data dhe thotë:

13 "Kërkesë

14 "Nuhi Bytyqi, gazetari i RTP-së kërkon që mundësisht të  
15 bëjë një reportazh rreth furnizimit me ndihma dhe jetën  
16 familjare."

17 Pikë së pari, Dëshmitar, keni punuar ndonjëherë gazetar  
18 për RTP-në ju?

19 PË. Po. Deri në vitin -- deri më 5 korrik të vitit 1990 kam  
20 qenë gazetar i Radiotelevizionit të Prishtinës.

21 PY. Rreth 18 majit 1998 a keni bërë ndonjë reportazh ju për  
22 furnizimin me ndihma dhe jetën familjare në Kosovë?

23 PË. Po. Kam përgatitur një emision special për gjendjen në  
24 zonat e luftës në Drenicë dhe për furnizimin me ndihma  
25 humanitare të popullatës civile.

1           Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që  
2 ky bllok shënimesh të pranohet si provë. Është sekuestruar nga  
3 shtëpia e Rexhep Selimit. Ju keni dëgjuar dëshmi që z. Selimi  
4 është takuar me këtë dëshmitar, dhe ky dëshmitar e ka  
5 konfirmuar në fakt që i ka bërë këto gjëra që thuhet në këtë  
6 shënim edhe që ka punuar si gazetar, sikurse edhe është cituar  
7 më herët. Mendoj që përmbush standardet *prima facie* për  
8 pranueshmërinë.

9           Z. TULLY: [Përkthim] E kundërshtojmë. Ne kundërshtojmë  
10 autorësinë e këtij blloku shënimesh. Janë disa shkrime të  
11 ndryshme dore këtu. Gjithashtu Prokuroria përpiqet të gjejë  
12 lidhje rrethore me datat. Dëshmitari thotë që ka ndodhur në  
13 fillim të majit dhe kjo është në fund të majit, gjysmën e dytë  
14 të majit.

15           Gjithashtu kundërshtojmë veprimtaritë që janë përshkruar  
16 këtu. Edhe sa i takon komunikimit që ka pasur ai me z. Selimi  
17 në fillim të majit. Faleminderit.

18           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka gjë  
19 tjetër?

20           Z. EMMERSON: [Përkthim] Ne përsërisim të njëjtin  
21 kundërshtim që kemi gjithmonë që ky është një dokument të  
22 cilit s'i vërtetojmë do autorësinë dhe për rrjedhojë nuk duhet  
23 pranuar.

24           DËSHMITARI: Kam për të shtuar, kam për të shtuar lidhur  
25 me këtë.

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 71

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër.

2 DËSHMITARI: Kjo është shkrim i Imer Halimit i cili ka  
3 qenë anëtar i këshillit të emergjencës në Prishtinë dhe me z.  
4 Imer Halimi jam takuar dhe biseduar, meqenëse ka qenë anëtar i  
5 këshillit për emergjencë në nivel të Kosovës, që të më  
6 ndihmojë për të bërë një emision special për ndihmat,  
7 furnizimin e popullatës civile me ndihma humanitare, me  
8 artikuj ushqimorë dhe të tjerë dhe kështu kam realizuar këtë  
9 emision, duke përfshirë këtu kryetarin e këshillit qendror për  
10 emergjencë z. Selatin Novosella, pastaj udhëheqësin e  
11 atëhershëm të shoqatës humanitare bamirëse "Nënë Terezë" në  
12 Prishtinë, Jak Mitën dhe disa veprimtarë të tjerë që kanë  
13 vepruar në zonat e luftës për ndihmuar popullatën civile. Do  
14 të thotë Ymer Halimi nuk ka qenë ndonjë funksionuar i UÇK-së  
15 por ka qenë profesor universiteti dhe ka qenë anëtar i  
16 këshillit të emergjencave.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
18 ngadalësoni, ngadalësoni pak ju lutem, sepse përkthyesit nuk  
19 ju ndjekin dot.

20 DËSHMITARI: Më falni, kërkoj falje. Kam punuar për një  
21 kohë të gjatë me edicionin e lajmeve dhe më ka mbetur si  
22 shprehi të flas shpejt. Edhe kështu siç thashë ta konfirmoj --

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
24 pra, ju po thoni që deklarata këtu është e saktë apo jo? Kjo  
25 që është thënë këtu, a është e saktë, apo jo?

1 DËSHMITARI: Duhet me i dhënë kahje tjetër. Unë e  
2 kundërshtoj këtë, sepse Imer Halimi nuk ka qenë ndonjë person  
3 që ka qenë me uniformë ushtarake dhe që ka dit strukturën dhe  
4 hierarkinë e UÇK-së, por ka qenë profesor universiteti dhe ka  
5 qenë anëtar i këshillit të emergjencës në nivel të Kosovës.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ishte kjo  
7 pyetja. Unë po ju pyes kështu: A po thoni ju që kjo deklaratë  
8 është e saktë apo jo?

9 DËSHMITARI: Po emisioni, emisioni është realizuar, është  
10 e saktë që është përgatitur emisioni special --

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
12 përgjigjuni, përgjigjuni. Po thoni, po thoni që kjo në ekran,  
13 kjo në ekran është e saktë apo jo? Kjo deklarata në ekran e  
14 kemi fjalën.

15 DËSHMITARI: Atëherë sigurisht.

16 Z. TULLY: [Përkthim] Ju lutem, dua të them diçka.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

18 Z. TULLY: [Përkthim] Nëse do ta pranoni këtë dokument  
19 atëherë ne do bëjmë edhe një kundërshtim tjetër për ta pranuar  
20 dokumentin në tërësinë e vet. Është një shënim atje për të  
21 cilin kontestojmë autorësinë -- ne e kontestojmë në  
22 përgjithësi, sepse duket sikur këtu ka pasur autorë të  
23 ndryshëm. Dëshmitari, mbasi mund të vërtetojë autorësinë e një  
24 pjesë këtu, por nuk mund të vërtetojë 85 faqe dokument.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,



Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 73

1 atëherë. Do ta shohim ne edhe do të vendosim nëse do ta  
2 pranojmë më vonë.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Ne kemi kërkuar vazhdimisht të  
4 pranohen blloqe të tilla shënimesh në këtë proces gjyqësor dhe  
5 kemi kërkuar që të pranojmë në tërësinë e tyre, sepse bën  
6 kontekste më të plotë. Nuk thamë ne që është autor Rexhep  
7 Selimi për këtë bllok shënimesh. Thamë thjesht që e kemi  
8 marrë, është sekuestruar nga shtëpia e tij.

9 Ne mendojmë që dëshmitari dha përgjigje të sakta Trupit  
10 Gjykues dhe besojmë që përmbush kriteret e pranueshmërisë.

11 Z. TULLY: [Përkthim] Pra, po thoni që nuk është blloku i  
12 shënimeve, është i z. Selimi dhe as nuk e atribuoni me të?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk është e qartë kush e ka  
14 shkruar. Ne po themi që e kemi gjetur në shtëpinë e z. Rexhep  
15 Selimi që mendojmë që në vetvete është tregues autenticiteti.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

17 Z. HALLING: [Përkthim]

18 PY. Dëshmitar, flasim për diçka tjetër. Në faqen 235 të  
19 librit ke folur për Sami Lushtakun dhe aty ke thënë që ke  
20 lexuar intervista në media dhe ke lexuar një intervistë që i  
21 ka dhënë gazetës Kombi dhe është intervistuar nga Haqif  
22 Mulliqi - ju kërkojmë ndjesë për shqiptimin.

23 PË. Haqif Mulliqi. Kolegu Haqif Mulliqi ka realizuar  
24 intervistën në revistën *Kombi* me z. Sami Lushtaku, është e  
25 vërtetë. Kjo ka qenë publike, është botuar.

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 74

1 PY. Kjo është ajo intervista që ke lexuar në maj të 1998?

2 PË. Po.

3 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës  
4 këshillohen]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Harruam të  
6 thonim për procesverbal numrin e provës për identifikim.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Materiali me numër  
8 SPOE00226527 deri në SPOE00226613-ET dhe versioni në anglisht  
9 i rishikuar shënohet për identifikim dhe merr numrin e provës  
10 materiale P01265 me klasifikim konfidencial. Ju faleminderit.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

12 PY. Në rregull. Flasim për atë që po diskutonim për  
13 intervistën e Sami Lushtakut.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Për këtë qëllim, le të nxjerrim në  
15 ekran materialin që mban numrin SPOE00230057 deri në  
16 SPOE0023058. Do fillojmë në faqen 2 që mban numrin  
17 SPOE00230508 [Sipas përkthimit].

18 PY. Dëshmitar, kjo është një intervistë e Sami Lushtakut e 23  
19 [Sipas përkthimit] majit '98. E kuptoj që këtë intervistë për  
20 herë të parë e keni parë gjatë seancës përgatitore, kështu?

21 PË. Po e kam parë këtë intervistë gjatë seancës përgatitore  
22 dhe kam deklaruar se kjo intervistë është botuar, qenka botuar  
23 në gazetën *Bota Sot*, jo në *Kombi*. Prandaj, ju lutem, për  
24 intervistat e gazetarëve kolegëve të mi, kolegëve të tjerë mos  
25 më pyetni.

1 PY. Dëshmitar, unë thjesht po ju pyes t'u përgjigjuni  
2 pyetjeve të mia. Arsyeja pse po e shfaqim intervistën nuk  
3 ishte pyetja që bëra unë. Sami Lushtaku thotë kështu:

4 "Deri më sot nuk kemi vrarë as gra as fëmijë; kemi vrarë  
5 oficerë policie, ushtarë dhe kolaboracionistë. Duhet të merrni  
6 parasysh tani një faktor të rëndësishëm që të gjithë  
7 kolaboracionistët që janë likuiduar kanë qenë pjesë e forcave  
8 okupatore të sistemit okupator në Kosovë dhe asnjë prej tyre  
9 nuk ka qenë i paarmatosur."

10 Shohim faqen e parë të intervistës. Dëshmitar, e shihni  
11 emrin e gazetarit lart. A është ky i njëjti gazetar që ke  
12 përmendur ti dhe në librin tënd dhe ke thënë që e ka  
13 intervistuar Sami Lushtakun për Kombin?

14 PË. Po, është i njëjti gazetar Haqif Mulliqi, por si thashë  
15 edhe më herët, i kam thënë edhe në takimin bashkë që e kemi  
16 pasur javën e kaluar që për intervistat të kolegëve të mi mos  
17 më pyetni. Nuk mbaj përgjegjësi unë për ato intervista.

18 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne mendojmë  
20 që ky është një dokument që mund të pranohet sipas kategorisë  
21 për prova jогоjore. Kjo është një material që është  
22 sekuestruar, po ashtu nga shtëpia e Rexhep Selimit. Është një  
23 intervistë me Sami Lushtakun me një gazetar që dëshmitari e ka  
24 vërtetuar se është një gazetar dhe intervistën e tij e ka  
25 parë, por në një media tjetër. Ne mendojmë që kjo përmbush

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 76

1 kriteret *prima facie* për t'u pranuar dhe kërkojmë që të  
2 pranohet si provë gjyqësore.

3 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

4 Z. TULLY: [Përkthim] E kundërshtojmë përdorimin e  
5 dokumentit të sekuestruar nga shtëpia e Rexhep Selimit, sepse  
6 nuk ka tregues autenticiteti kjo gjë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kundërshtimi im është disi  
9 ndryshe. Me sa po kuptoj unë ky dëshmitar thjesht ka parë një  
10 gazetë dhe e kanë pyetur a e njeh gazetarin. Por kjo nuk është  
11 një bazë për pranimin e këtij dokumenti si provë gjyqësore.  
12 Është si të hap unë tani një gazetë tani e të them, oh e njoh  
13 unë gazetarin këtu.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, ka diçka më shumë se kaq.  
15 Dëshmitari tha që ka parë një intervistë në një botim tjetër,  
16 por që janë të njëjtët persona. Ne mendojmë që ia kemi dhënë  
17 dhe kontekstin pse duhet pranuar kjo intervistë sipas  
18 kriterëve *prima facie*. Mendojmë që dëshmitari ka vërtetuar  
19 faktin që e njeh këtë person.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të  
21 pranohet sipas rregullës 133; përmbush standardin *prima facie*  
22 dhe është dokument relevant.

23 Ka vlerë provuese e cila nuk tejkalohet nga aspektet  
24 cenuese. Pra, vlera provuese nuk zhbëhet nga efekti cenues -  
25 më falni.

1 Dokumenti me numër SPOE00230057 - SPOE00230058 pranohet.

2 Të dyja faqet apo një faqe?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Po kërkoj që të pranohen të dyja  
4 faqet, çka do të thotë intervista e plotë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
6 Pranohet faqja 1 dhe faqja 2.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Këtë dokumente -- ky  
8 dokument merr numrin e provës materiale P01266 me klasifikim  
9 konfidencial.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

11 Z. HALLING: [Përkthim]

12 PY. Dëshmitar, tani do flasim për një dokumentar që ke bërë  
13 për nder të Agim Qelajt. Kur është transmetuar ky dokumentar?

14 PË. Ky dokumentar është transmetuar në përvjetorin e rënies  
15 heroike të gjeneral Agim Qelajt në vitin 2009, më duket. Ashtu  
16 2009 duhet të jetë.

17 PY. Faleminderit.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo është videoja e parë që do të  
19 shohim. I lutem Sekretarit të Gjykatës që të vendosë në ekran  
20 videon me numër 077572-01 dhe përkthimin në anglisht që t'i  
21 kemi përbri njëra-tjetrës në ekran.

22 PY. Dëshmitar, do shohim një pjesë të videos dhe ju do të  
23 dëgjoni përmes përkthimit atë pjesë që më intereson mua nga  
24 videoja.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Nga sekonda e 3-të, ju lutem, deri

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 78

1 në minutën 1:01. Në transkript është faqja e parë. I lutem  
2 Sekretarit të vendosë videon.

3 [Luhet videoincizimi]

4 PËRKTHYESI: "Më 12 mars pas rënies së Jasharajve në zyrën  
5 e qeverisë vonë kanë ardhë 14 ushtarakë, midis tyre Agim  
6 Çelaj, si më kujtohet si sot. Pastaj ka qenë Bislimi, si  
7 zakonisht, Salihu, Kemal Shaqiri, Rustem Berisha dhe të  
8 gjithë kanë qenë të gatshëm me hy në frontin e luftës. Atë  
9 ditë [E pakuptueshme] zhvilloshin luftën në front; në front  
10 ishte edhe Kadri Veseli dhe u lidh me telefon, u lidh me  
11 telefon, bisedon, thotë, profesor dëgjoj granatimet që i bën  
12 Serbia kundër popullatës. Ne jemi në front. Agim Çelaj m'u  
13 lut. Profesor muj me marrë telefonin, i dhashë telefonin edhe  
14 si themi ne, nisesh shkurt e mësonte kështu duhet të bëhet  
15 istikami, futnu këtu, ata në këtë. Me lot në sy e kemi mbyll  
16 atë takim, e kemi mbyll atë takim. Agimi ka qenë i gatshëm  
17 prej atyjit me u nis menjëherë për në front".

18 Z. HALLING: [Përkthim]

19 PY. Dëshmitar, ky është dokumentari që sapo pamë?

20 PË. Një pjesë e dokumentarit; një pjesë.

21 PY. Po, një pjesë. Po kush ishte personi që po fliste që pamë  
22 ne?

23 PË. Ishte profesor Mujë Rugova.

24 PY. Për cilin periudhë kohore bëhet fjalë, kur kanë ndodhur  
25 këto ngjarje që përshkruan Mujë Rugova në këtë pjesë?

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 79

1 PË. Po këto kanë -- flitet për ngjarje që kanë ndodhur pas  
2 epopesë së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës më 5-6-  
3 7 mars të vitit 1998 në Prekaz, pas rënies heroike të  
4 komandantit legjendar Adem Jashari dhe të familjes Jashari dhe  
5 kur është mobilizuar mbarë populli shqiptar, por edhe mërgata  
6 jonë për t'ju bashkëngjitur Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

7 PY. Pra, çfarë muaji dhe çfarë viti?

8 PË. Po, mars, thashë, mars të vitit 1998.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në fakt pyetja është pak e  
10 paqartë. Kjo është një intervistë me një person që përshkruan  
11 një ngjarje që ka ndodhur pas masakrës së Jasharëve. Pra, pas  
12 12 marsit 1998.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pajto --

14 Z. EMMERSON: [Përkthim] Se çfarë relevance kishte data  
15 këtu nuk e kuptojmë. Vetëm kuptohet që [E pakuptueshme].

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pajtohem.

17 Pyetja ishte e paqartë.

18 Z. HALLING: [Përkthim]

19 PY. Kur flet Mujë Rugova këtu për atë thirrjen që ka marrë  
20 nga Kadri Veseli, kur ka ndodhur kjo thirrje telefonike? Në  
21 cilën periudhë kohore?

22 PË. Unë nuk e di saktë, por besoj Mujë Rugova flet pas 12  
23 marsit 1998.

24 PY. Faleminderit.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Besoj se u sqaruar tani.

1 Tani do shohim një pjesë tjetër po të së njëjtës video.  
2 Të shohim nga minuta e 5-të, sekonda e 39-të deri në minutën e  
3 5-të në sekondën e 56-të. Është faqja e 3-të në transkriptin  
4 në gjuhën angleze me të njëjtën video.

5 [Luhet videoincizimi]

6 PËRKTHYESI: "Përmes veriut të Shqipërisë Kadri Kastrati,  
7 Agim Çela dhe disa të tjerë kemi hyrë në Kosovë".

8 "Terreni ishte pak i panjohur për ne për arsye se nuk  
9 ishte ..."

10 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

11 PY. Dëshmitar, a ishte Hashim Thaçi ai që po fliste në të  
12 njëjtin dokumentar për Agim Qelajn?

13 PË. Po.

14 PY. Përafërsisht ngjarjet që përshkruan Hashim Thaçi në këtë  
15 pjesë të dokumentarit kur ka ndodhur? Përafërsisht në cilin  
16 periudhë kohore?

17 PË. Nuk e thotë z. Thaçi saktësisht në cilën periudhë. Flet  
18 në përgjithësi.

19 PY. Ai aty përshkruante, të paktën te pjesa e videos që pamë  
20 ne e thoshte që, "të gjithë ne shkuam nga pjesa veriore e  
21 Shqipërisë drejt Kosovës". Dhe unë pyetjen e kisha: Në qoftë  
22 se e dini kur ka shkuar Hashim Thaçi me këtë grup nga veriu i  
23 Shqipërisë drejt Kosovës?

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtoj për themelësinë.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Edhe unë e kundërshtoj, pyetja



Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 81

1 është bërë dhe përgjigja është marrë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
3 nëse e dini përgjigjen mund ta jepni.

4 DËSHMITARI: Unë e dhashë përgjigjen. Nuk e di saktë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po mund t'i  
6 përgjigjeni në qoftë se e dini.

7 DËSHMITARI: Nuk e di.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Atëherë do ta  
9 ndihmojmë dëshmitarin me kujtesën edhe duhet të kërkoja që t'i  
10 tregonim paragrafin 64 të Shënimit Përgatitor Nr. 2.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

12 Z. HALLING: [Përkthim]

13 PY. Dëshmitar, do shohim shënimin përgatitor që i përkon  
14 kësaj pjese të videos që e keni parë gjatë seancës  
15 përgatitore. Ju keni thënë këtu:

16 "Ngjarjet që përshkruan Hashim Thaçi këtu kanë ndodhur  
17 për afërsisht rreth datës 28 maj 1998, bazuar në informacionin  
18 që Isuf Çela [Sipas përkthimit] i ka dhënë Adem Çelajt [Sipas  
19 përkthimit] në dokumentarin e Adem Çelajt?" [Sipas përkthimit]

20 Kështu?

21 PË. Ju lutem përkthyesja po bën disa gabime në emër. Jo Adem  
22 Qelaj, por Agim Qelaj, dhe jo Jusuf, s'di se çfarë mbiemri  
23 përdori, Isuf Gashi.

24 PY. Do t'jua lexoj edhe një herë unë. Dëshmitar, këtë keni  
25 thënë ju dhe është në shënimin përgatitor 2:

1 "Ngjarjet që përshkruan Hashim Thaçi këtu kanë ndodhur  
2 rreth datës 28 maj 1998, bazuar në informacionin që Isuf Gashi  
3 ka dhënë në dokumentarin e Adem Qelajt", kështu? Agim Qelajt -  
4 më falni - kështu?

5 PË. Ashtu duhet të jetë. Po lëshoni -- ju s'e lëshuat pjesën  
6 filmike të dokumentarit që të argumentohet kjo.

7 PY. Faleminderit.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Në rregull, atëherë. Shohim  
9 materialin me numër 077573-01, është faqja 1 e transkriptit në  
10 gjuhën angleze. Më konkretisht na nevojitet minutazhi nga  
11 sekonda e 30-të deri në minutën 1, sekonda e 7-të.

12 [Luhet videoincizimi]

13 PËRKTHYESI: "E formimin për riorganizimin....".

14 Z. HALLING: [Përkthim] Sekretarit, ju lutem, nga sekonda  
15 e 30-të deri në minutën 1:97.

16 [Luhet videoincizimi]

17 PËRKTHYESI: "...Nezha. Me ardhjen e këtij grupi  
18 ushtarakësh, me vendim të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë  
19 Çlirimtare të Kosovës gjithë këta ushtarakë u shpërndanë në të  
20 gjitha zonat operative të Kosovës. Agim Qela u ngarkua nga  
21 Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që të  
22 punojë në personalizimin e njësive të specializuara të  
23 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në nivel të Shtabit të  
24 Përgjithshëm, por edhe në nivel të zonave operative dhe  
25 inspektimit të zonave operative".

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 83

1 Z. HALLING: [Përkthim]

2 PY. Dëshmitar, a është kjo pjesë një pjesë tjetër e të  
3 njëjtit dokumentari të Agim Qelajt që kemi diskutuar deri  
4 tani, kjo që sapo dëgjua?

5 PË. Po.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në përputhje  
7 me udhëzimet e mëparshme të Trupit Gjykues neve do paraqesim  
8 një pjesë të videove vetëm për ato pjesë që na nevojiten për  
9 të bërë pyetjet tona.

10 Në këtë rast, këto dy ERN janë pjesë e një dokumentari më  
11 të gjerë ose të të gjithë dokumentarit të bërë nga Agim Qelaj.  
12 Megjithatë ne do të sugjeronim që të bënim paraqitjen -- të  
13 këtij dokumenti ose të kësaj videoje në tërësinë e vet,  
14 pavarësisht nga fakti që do të përdorim fragmente të caktuara  
15 të kësaj, të këtij dokumentari. Kështu që për tani duam që të  
16 kërkojmë që të paraqitet si provë pjesa 077572-01 deri në  
17 0775731-01.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka  
19 kundërshtim?

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

21 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kemi as ne kundërshtim.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

23 Dokumenti 077572-01 pranohet si provë materiale dhe do t'i  
24 caktohet një numër prove nga Sekretari.

25 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 84

1 provës materiale P01267. Të nderuar Gjykatës, videoja është e  
2 klasifikuar si publike. Megjithatë transkripti është  
3 konfidencial.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]  
5 Duhet të jetë edhe transkripti publik.

6 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull. E morëm  
7 shënim dhe këtë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
9 Dokumenti 077573-01 pranohet si provë.

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dhe do të marrë numrin e  
11 provës P01268 dhe do të klasifikohet si publik.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
13 Mund të vazhdoni, Prokuror.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

15 PY. Dëshmitar, dokumenti tjetër që duhet t'ju tregoj është  
16 një pjesë e seancës përgatitore.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Kështu që do i kërkoja Sekretarit  
18 të paraqesë në ekran dokumentin SPOE00225778 deri në 00225779  
19 në shqip dhe në anglisht. Do kërkoja që të paraqitet faqja e  
20 dytë në ekran. Më konkretisht, kjo faqe mban numrin  
21 SPOE00225779.

22 PY. Dëshmitar, këtë faqe na keni thënë që nuk e keni parë  
23 përpara sesa t'jua tregonim në seancë përgatitore, a është e  
24 saktë kjo?

25 PË. Po.

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 85

1 PY. Ky numri 26 625, çfarë është ky numri te kjo faqja, çfarë  
2 është?

3 PË. Sigurisht ka qenë telefoni im fiks në banesë.

4 PY. Faleminderit.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do i kërkoja Sekretarit që të  
6 kalojmë te faqja e parë.

7 PY. Ajo çfarë shohim këtu është një raport, Dëshmitar. Është  
8 një raport që është bërë në Drenoc dhe që i drejtohet z. Daja.  
9 Me çfarë e kemi kuptuar, ju nuk është se keni parë ose lexuar  
10 këtë raport më përpara. Hera e parë që e keni parë ka qenë  
11 përpara një jave, apo jo, Dëshmitar?

12 PË. Ashtu është.

13 PY. A e njihni një person me emrin Gjermani në bazën e  
14 Drenocit siç thuhet në paragrafin e dytë të këtij raporti?

15 PË. Po, në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ka pas shumë  
16 luftëtarë që ka pas pseudonimin Gjermani. Në mesin e tyre në  
17 Drenoc ka qenë Xhemë Gashi, me sa e di unë. Por në zona të  
18 tjera ka pas, është luftëtarë që kanë pasur të njëjtin  
19 pseudonim.

20 PY. A jeni në gjendje të thoni se kush është Daja ose ky  
21 personi që njihet si Bis, ose shkruhet Bis këtu në raport? E  
22 keni idenë kush më të jenë këta?

23 PË. Në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, po ashtu ka pas shumë  
24 luftëtarë që kanë pasur pseudonimin Daja. Ka qenë Azem Sylja,  
25 Daja, si e përmendi zakonisht komandanti i përgjithshëm edhe

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 86

1 pastaj ka qenë Kadri Kastrati, Daja, por ka qenë Daja i Vogël,  
2 Hysni Syla e të tjerë, e të tjerë.

3 Kurse për Bis nuk e di, se kujt i kanë thënë Bis -- ka  
4 pas shumë Bisa sigurisht, por për cilin Bis është fjala nuk e  
5 di.

6 PY. Në rregull.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, duke marrë  
8 parasysh kombinimin e dëshmitarit që identifikon numrin e tij  
9 të telefonit në fund të raportit dhe faktin që identifikon  
10 emrin e një prej nofkave të personave të lidhur me vendin e  
11 referencës në Drenovc; dhe faktin që ky material është marrë  
12 nga shtëpia e Jakup Krasniqit; dhe faktin që dëshmitari tha që  
13 ka pasur ushtarë të UÇK-së që njiheshin me këto emra ose këto  
14 nofka, neve kërkojmë që ky dokument të pranohet si provë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

16 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e  
17 kundërshtojmë pranimin e këtij dokumenti, sepse nuk e dimë se  
18 nga ka ardhur, nga e ka prejardhjen ky dokument. Fakti që ky  
19 dokument është marrë nga shtëpia e z. Krasniqi në vetvete nuk  
20 është se përcakton autenticitetin e tij.

21 Z. TULLY: [Përkthim] Kundërshtojmë dhe neve, sepse nuk ka  
22 lidhje ndërmjet dy gjërave që parashtrojnë Prokuroria. Vetëm  
23 thjesht që njeh -- që pa emrin e vet. Pra, unë kundërshtoj,  
24 sepse nuk mendoj që dëshmitari ka dhënë informacion të  
25 mjaftueshëm për të vërtetuar përmbajtjen e tij.

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 87

1 Në qoftë se ka thënë që ka dëgjuar dy ose tre nofka të  
2 ndryshme të personave që ishin pjesë e UÇK-së kjo në vetvete  
3 nuk mjafton.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

5 Z. EMMERSON: [Përkthim] Është pjesë e kundërshtimit të  
6 vazhdueshëm nga ekipi i z. Veseli.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do japim një  
8 numër provizor prove materiale dhe pastaj do ta shikojmë në më  
9 tepër hollësi. Mund të vazhdoni. Jo -- Së pari t'i caktojë  
10 numrin MFI Sekretari.

11 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar  
12 Gjykatës. Dokumenti SPOE00225778 deri në SPOE00225779 do të  
13 marrë numrin MFI P0269 [Sipas përkthimit] dhe aktualisht është  
14 klasifikuar si konfidencial.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kërkoj  
16 ndjesë, por thatë 1269 apo jo?

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Po, do të marrë numrin  
18 MFI 1269.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Kërkojmë, të nderuar  
21 Gjykatës, që ky material të konsiderohet në kontekstin e  
22 materialeve të tjera që flasim për të njëjtin vend edhe për të  
23 njëjtit njerëz.

24 PY. Tani do të shikojmë një pjesë tjetër të librit tënd.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Do shkojmë te faqja 243 e këtij

- 1 libri. Për Sekretarin numri SPOE është 00128613.
- 2 PY. Dëshmitar, ndërsa Sekretari e paraqet dokumentin në  
3 ekran, Baca, kush e ka pas nofkën në librin tuaj? Kush është  
4 personi me nofkën Baca?
- 5 PË. Baca ka pas shumë luftëtarë që kanë pas këtë pseudonim.  
6 Njëri ndër ta Isuf Gashi, Baca.
- 7 PË. Po, Florim Gashi, kush është?
- 8 PË. Florim Gashi është nipi im, djali i Bacës.
- 9 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë edhe një herë për  
10 Sekretarin, faqja është SPOE00128613.
- 11 Z. HALLING: [Mikrofoni çaktivizuar].
- 12 Z. HALLING: [Përkthim]
- 13 PY. Atëherë këtu në dokument thuhet:  
14 "Ditën e nesërme u çuan dhe i thamë Bacës dhe Florimit që  
15 do ishte më mirë që të takoheshin dhe t'ia jepnin këtë  
16 informacion dikujt në Shtabin e Përgjithshëm. Dhe Florimi më  
17 tha, 'Axhë është më mirë që të presim pak më tepër, sepse na  
18 duhet që të takohemi me personin që është përgjegjës për  
19 këtë'".
- 20 Kjo bisedë që sapo ju përshkrova në çfarë kohe ka  
21 ndodhur, Dëshmitar?
- 22 PË. Por kjo duhet të jetë fundi i majit ose fillimi i  
23 qershorit i vitit 1998.
- 24 PY. Kjo bisedë, a ka ndodhur përpara sesa ju të takoheshit  
25 për herë të parë me Hashim Thaçin?



1 PË. Po, me Florimin, nipin tim jam takuar në Prishtinë. Ai ka  
2 qenë gazetar i revistës *Zëri* dhe kemi bashkëpunuar. Pastaj  
3 kemi shkuar bashkë në shtëpinë e tij, në fshatin Drenovc të  
4 Rahovecit. Këtu jemi takuar për herë të parë me z. Thaçi.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Kalojmë te faqja tjetër. Te faqja  
6 tjetër përshkruan këtë takim. Është faqja 244 e librit. Të  
7 presim një çast.

8 PY. Këtu thuhet:

9 "Pas një periudhe të shkurtër një person i gjatë erdhi me  
10 uniformë të UÇK-së. U përshëndetëm dhe ai u prezantua si  
11 komandanti Gjarpri. Më vonë mësuam se ai ishte Hashim Thaçi i  
12 cili ndërkohë u emërua udhëheqës politik i UÇK-së.

13 Këtu në libër thoni "pas pak kohe". A ka ndodhur kjo në  
14 të njëjtën ditë kur ka ndodhur kjo biseda me Florim Gashin që  
15 jua përshkrova në faqen, një faqe më përpara.

16 PË. Po, kjo është në të njëjtën ditë. Dhe z. Thaçi në atë  
17 kohë ka qenë përgjegjës për informim. Kurse, siç shkruan edhe  
18 në libër, ndërkohë në nëntor të vitit 1998 është zgjedhur  
19 udhëheqës politik i UÇK-së.

20 PY. Këtu thuhet se UÇK-ja ishte - më falni - Hashim Thaçi  
21 ishte zëdhënës i UÇK-së. A është dëshmia jua që Hashim  
22 Thaçi ishte zëdhënës i UÇK-së?

23 PË. Nuk shkruante që ka qenë zëdhënës -- Hashim Thaçi  
24 zëdhënës i UÇK-së, por përgjegjës për informim.

25 PY. Në rregull. Kalojmë te faqja 247 e librit. Për Sekretarin

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 90

1 është me numër SPOE00128617. Këtu përshkruhet një bisedë  
2 telefonike që keni pasur ju dhe Hashim Thaçi me njëri-tjetrin.

3 Këtu thuhet:

4 "Shumë vonë më 10 qershor [Sipas përkthimit] Hashim Thaçi  
5 më thërriti në telefon...".

6 Pra, Dëshmitar, a ka ndodhur kjo thuajse 10 ditë më pas  
7 takimit të parë që ju keni pas me Hashim Thaçin që e diskutuam  
8 përpara një çasti?

9 PË. Po ashtu është. Shkruan saktë më 10, mes datës 10 dhe 11  
10 qershor të vitit 1998, natën.

11 PY. Ai më tha:

12 "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ka caktuar profesor Jakup  
13 Krasniqin zëdhënës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. A mund  
14 të vish nesër në Grykën e Llapushnikut që ta realizosh  
15 intervistën me zëdhënësin e UÇK-së?".

16 Ndalojmë këtu për një çast. Jakup Krasniqi a u caktua  
17 zëdhënës i UÇK-së dhe a e ke mësuar ti këtë informacion me  
18 datë 11 qershor 1998, Dëshmitar?

19 PË. Po, e kam mësuar nga z. Thaçi dhe është publikuar lajmi  
20 edhe në mediat e atëhershme.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Tani kalojmë tek dokumenti U015-  
22 8743 deri U015-8935. Më konkretisht dua të paraqitet faqja  
23 U015-8833.

24 PY. Ndërsa paraqitet kjo dokument, -- ky dokument, do t'ju  
25 pyes, Dëshmitar, në qoftë se e njihni një libër që e ka

1 shkruar Jakup Krasniqi që quhet "Kthesa e Madhe"?

2 PË. Po. Z. Krasniqi ka botuar këtë libër dhe ma ka dhuruar.

3 Një pjesë të atij libri e kam lexuar; nuk kam arritur ta lexoj  
4 të tërin. Kjo është ajo që e kam deklaruar dhe në bisedën  
5 paraprake.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Faqja konkrete që dua të paraqitet  
7 në shqip dhe në anglisht është U015-8833.

8 PY. Dëshmitar, a e dini se ku ka jetuar z. Krasniqi në atë  
9 kohë? Pra, kur u bë zëdhënës i UÇK-së, ku ka jetuar z.  
10 Krasniqi?

11 PË. Nuk e di saktë ku ka jetuar, por vendlindja e tij është  
12 Negroc i komunës së Drenasit.

13 PY. Faleminderit. Në këtë faqe shikojmë pak vetëm versionin  
14 në anglisht. Nuk e shikoj shqipen, por ndoshta do ishte mirë  
15 që të vazhdojmë me anglishten edhe ju mund të na dëgjoni  
16 përmes përkthimit. Kjo është pjesë e librit të Jakup  
17 Krasniqit. Thuhet:

18 "... Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së i njoftuar më 11  
19 qershor '98 nga deklarata politike nr. 3 e caktoi zëdhënësin e  
20 UÇK-së Jakup Krasniqi, mësuesi i historisë nga Negroci i  
21 Drenicës".

22 Pra, ju këtë informacion e keni mësuar në të njëjtën  
23 ditë, të njëjtën datë, apo jo, Dëshmitar?

24 PË. Po, si duket të njëjtën datë.

25 PY. Pak më poshtë te kjo faqja thuhet, pra, thuhet nga Jakup

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 92

1 Krasniqi: "Përbërja e UÇK-së është konfirmuar nga takimi i  
2 Shtabit të Përgjithshëm në Negroc".

3 A keni pas informacion ju për këtë takim in e Shtabit të  
4 Përgjithshëm të organizuar në Negroc në atë kohë, Dëshmitar?  
5 PË. Nuk kam pas.

6 PY. A jeni takuar me ndonjë anëtar të Shtabit të Përgjithshëm  
7 në ditët përreth 11 qershorit të '98-s?

8 PË. Jam takuar me z. Kadri Veseli në Negroc para se të  
9 realizoja paraqitjen e parë publike me zëdhënësin e Ushtrisë e  
10 Çlirimtare të Kosovës, z. Jakup Krasniqi, në Kleçkë më 14  
11 qershor të vitit 1998.

12 PY. Dëshmitar, ju keni vizatuar një hartë gjatë seancës  
13 përgatitore me ne, a është e vërtetë kjo?

14 PË. Po.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që ta  
16 paraqesë këtë hartë. Është tek Shënimi Përgatitor Nr. 2. Është  
17 faqja e fundit e këtij shënimi. Për procesverbal është  
18 dokumenti 121260 deri në 121271, faqja konkrete është 121271.

19 PY. Dëshmitar, në librin tuaj ju flisni gjerësisht për pjesën  
20 e sekuencës ose se si u shpalosën ngjarjet. Ndërkohë që do  
21 flasim tani pak ose do ju bëj disa pyetje për aspektin e  
22 gjeografisë.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Pjesët përkatëse të librit janë në  
24 faqen 241 deri në 249 [Sipas përkthimit].

25 PY. Dëshmitar, a është kjo harta ku keni bërë shënime gjatë

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 93

1 seancës përgatitore?

2 PË. Po.

3 PY. Më 13 qershor 1998 jeni takuar me Kadri Veselin në Negroc  
4 dhe ai bëri një organizim që Idriz Hysenaj t'ju voziste ju me  
5 makinë në Tërpezë; a është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

6 PË. Po.

7 PY. Në mënyrë që të shkoje nga Negroci në Kleçkë, a ishte e  
8 nevojshme që të kalonit nga Tërpeza në këtë kohë?

9 PË. Po.

10 PY. Kur mbërritët në Tërpezë ju jeni dërguar nga Haxhi Shala  
11 nga Tërpeza në Kleçkë, e kam kuptuar drejt?

12 PË. Po, nga Haxhi Shala, po.

13 PY. Pastaj në Kleçkë aty takoheni me Fatmir Limajn dhe Kadri  
14 Veselin përsëri, ku me datë 14 [Sipas përkthimit] juve bëni  
15 filmimin e paraqitjes ose daljes së parë publike të  
16 zëdhënësit, kështu?

17 PË. Po.

18 PY. Përpara sesa të shohim një sekuençë të shkurtër të kësaj  
19 videoje, dëshiroj që të shohim së bashku një fotografi përveç  
20 kësaj hartës që keni bërë shënimet juve.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të  
22 paraqesë në ekran dokumentin SPOE00213798 deri në 00213850.

23 Faqja konkrete është SPOE0213800.

24 PY. Ndërkohë që paraqitet dokumenti dua t'ju pyes, Dëshmitar,  
25 sa larg është Negroci nga Tërpeza; sa është distanca ndërmjet

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 94

1 të dy vendeve?

2 PË. Kryesisht mund të jetë 15-20 minuta. Në atë koha nuk ka  
3 qenë rruga e asfaltuar, më ngadalë është dashtë të udhëtojmë.

4 PY. Dëshmitar, në këtë faqe kjo ndërtesa në të majtë në cep  
5 fare, çfarë është?

6 PË. Kjo ka qenë selia e njësimit Pëllumbi në atë periudhë, ku  
7 e kam realizuar paraqitjen e parë publike të z. Krasniqi.

8 PY. Në cilën pjesë të ndërtesës është filmuar paraqitja e  
9 parë e z. Krasniqi si zëdhënës?

10 PË. Këtu në këtë pjesën këtu.

11 PY. Në pjesën ose në cepin në të majtë më sipër është një  
12 fushë aty. A keni filmuar ndonjë gjë te kjo fusha gjatë  
13 luftës, Dëshmitar, dhe çfarë keni filmuar, në qoftë se po?

14 PË. Gjatë luftës pak më poshtë atje, kemi filmuar betimin  
15 solemn të ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për  
16 dokumentarin e parë kushtuar Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

17 PY. Faleminderit.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që  
19 të pranohet si provë harta ku ka bërë shënimet dëshmitari në  
20 seancën përgatitore. Është faqja 121271 nga Shënimi Përgatitor  
21 Nr. 2 si dhe këtë foto nga ajri të Kleçkës, përfshirë edhe  
22 shpjegimet e dëshmitarit. Është pjesë e SPOE00213800; është  
23 pjesë e një fotografie, e një game fotografish më shumë sesa  
24 kaq. Megjithatë duam që konkretisht tani të pranohet si provë  
25 vetëm fotografia që sapo pamë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka  
2 kundërshtim?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Harta në  
5 shënimin përgatitor 12160 - më falni - është 121271, pranohet  
6 si provë.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Nga ERN 121260 deri në  
8 121271 faqja konkrete 121271 do të marrë numrin e provës  
9 materiale P01270. Faleminderit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
11 SPOE00213800, që është fotografia që sapo pamë, pranohet si  
12 provë materiale.

13 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Kjo faqe do të marrë  
14 numrin e provës materiale P01271. Faleminderit.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit tani që të  
16 paraqesë në ekran dokumentin që është prova e pranuar P02155  
17 që është një video. Më konkretisht dua që të na paraqisni  
18 segmentin nga minuta e 1-rë në sekondën e 17-të, deri në  
19 minutën e 1-rë, sekonda e 44. Megjithatë përpara se të luhet  
20 dhe të shohim videon dua që t'i bëj një pyetje dëshmitarit.  
21 Ndërkohë që transkripti përkues është në faqen e transkriptit  
22 nr. 1. Domethënë, përpara sesa të shohim videon do ju bëj një  
23 pyetje, Dëshmitar.

24 PY. Dëshmitar, ndërkohë që paraqitet videoja, pra, në  
25 momentin kur ju po filmonit paraqitjen e parë publike të Jakup

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 96

1 Krasniqit në qershor të 1998-s, kush kanë qenë personat e  
2 tjerë atje; ata personat e tjerë përveç Jakup Krasniqit, kush  
3 kanë qenë; kë keni filmuar tjetër përveç tij?

4 PË. Tjetër filmim ka qenë në prapavijë z. Fatmir Limaj dhe  
5 Ferat Shala, kurse pas kamerës ka qenë z. Veseli.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Sa për ta konfirmuar për  
7 Sekretarin dhe një herë është dokumenti 061427-01. Kjo është  
8 numri ERN i videos. Është një prej provave materiale  
9 shoqëruese dhe është pranuar si provë sot. Numri që kam unë  
10 për këtë provë është P01255.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të jetë  
12 1255.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, faleminderit për  
14 korrigjimin. Është dokumenti 1255.

15 PY. Për ta plotësuar përgjigjen, a mund të na thuash që kush  
16 ka qenë kameramani që ka bërë filmimin bashkë me juve; si e ka  
17 pas emrin ky person?

18 PË. Po, kameramani ka qenë Abaz Zeka.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë, dhe një herë të  
20 transmetojmë nga minuta 1, sekonda e 17-të, deri në minutën 1,  
21 sekonda e 44-t. 10 sekonda më vonë, më pas. Faleminderit.

22 PY. Dëshmitar, duke filluar nga e majta tek e djathta; nga  
23 minuta e 1-të, sekonda e 17-të, na thoni kush janë këta  
24 personat që janë në ekran.

25 PË. Si thashë edhe më herët është z. Jakup Krasniqi në mes,



Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 97

1 kurse në të majtë është z. Ferat Shala dhe në të djathtë z.

2 Fatmir Limaj.

3 PY. Kjo është videoja e parë për paraqitjen e zëdhënësit në

4 Kleçkë në qershor të '98-s, kështu, Dëshmitar?

5 PË. Po.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarit që të na e  
7 paraqesë videon.

8 [Luhet videoincizimi]

9 PËRKTHYESI: "... është i mendimit se në këtë fazë të  
10 luftës pluralizmi politik është luks. Populli ynë ka nevojë  
11 për një force serioze politike, ushtarake që lufton për liri,  
12 për çlirim e bashkim. Ushtria Çlirimtare e Kosovës është  
13 përgatitur për të luftuar deri në fitore".

14 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

15 PY. Dëshmitar, na kanë ngelur dhe pak minuta përpara se të  
16 mbarojmë me këtë seancë dhe të fillojmë pushimin.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Mund ta fillojmë tani ose jo.

18 Megjithatë do i kërkoja Sekretarit që të na kalonte te një  
19 fotografi që është dokumenti SPOE00204122. Do i kërkoja  
20 Sekretarit të na e paraqesë fotografinë. Është një fotografi e  
21 cila është pjesë e librit të dëshmitarit. Është në faqen 350  
22 të librit.

23 Atëherë do presim dhe një çast që të paraqiten personat  
24 që janë në fotografi që të paraqiten në ekran. T'i shohim.

25 PY. Rreth çfarë kohe, në cilën periudhë ose në çfarë kohe

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 98

1 është bërë kjo fotografi, Dëshmitar?

2 PË. Kjo saktë më 17 qershor të vitit 1998.

3 PY. Nga e majta në të djathtë. A mund të na thoni se kush  
4 janë personat që tregohen në këtë fotografi?

5 PË. Është z. Hashim Thaçi; z. Kadri Veseli; unë; dhe Xhavit  
6 Ferizi, Komandant Raketa.

7 PY. Ku është bërë kjo fotografi; në çfarë vendi?

8 PË. Është bërë në [E pakuptueshme] sipërfaqësore në Bardh të  
9 Madh.

10 PY. Ju keni filmuar dhe një video në këtë vend.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Mbase kemi kohë ta transmetojmë.

12 Është vetëm 20 sekonda. Numri i referencës së videos është

13 095612-01 [Sipas përkthimit]. Nuk është e nevojshme që të

14 dëgjojmë transkriptin. Është vetëm thjesht pjesa pamore që

15 duhet të shohim. Atëherë do ju kërkoja që ta transmetoni këtë

16 video nga sekonda e 20-të deri në sekondën e 40-të, Sekretar.

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mund ta përsërisni edhe  
18 një herë numrin ERN?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Po, patjetër. Është 095692-01.

20 Edhe një herë dua që të transmetohet nga sekonda e 20-të, deri  
21 në sekondën e 40-ë.

22 Atëherë dhe një herë nga sekonda e 20-të, deri në  
23 sekondën e 40-ë, Sekretar.

24 [Luhet videoincizimi]

25 [E padëgjueshme]

1 Z. HALLING: [Përkthim]

2 PY. Dëshmitar, a e keni bërë ju këtë filmim përsëri në të  
3 njëjtën datë, me datë 17 qershor 1998 nga Bardhi i Madh?

4 PË. Po. E ka bërë kameramani Abaz Zeka më 17 qershor të vitit  
5 '98.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Tani të kalojmë te sekonda e 27  
7 dhe dua që të paraqitet si foto e ngrirë në ekran sekonda e 27  
8 e videos.

9 PY. Nga e majta në të djathtë, a mund të na thoni se kush  
10 janë këta persona që tregohen tek kjo fotografia e ngrirë në  
11 ekran?

12 PË. Është Isak Qoli, Qolli; Kadri Veseli në mes; edhe Hashim  
13 Thaçi është në të djathtë.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Z. Qolli diskutohet më tej në  
15 librin e dëshmitarit. Kështu që do kërkojmë që të paraqitet  
16 dhe të pranohet si provë kjo fotografi dhe video dhe ka ardhur  
17 koha që të bëjmë dhe pushimin e drekës. Edhe një herë  
18 dokumenti SPOE00204122 për fotografinë dhe 0959612 [Sipas  
19 përkthimit] për videon.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka  
21 kundërshtim?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

23 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
25 SPOE00204122 pranohet si provë materiale.

1 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do marrë numrin e provës  
2 materiale P01272.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]  
4 Atëherë dhe një herë: Dokumenti 095692-01 pranohet si  
5 provë materiale.

6 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do t'i caktohet numri i  
7 provës materiale P01273. Aktualisht klasifikohen të dy  
8 dokumentet si publike. Ju faleminderit, të nderuar Gjykatës.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
10 Faleminderit.

11 Dëshmitar, tani do bëjmë pushimin e drekës. Do bëjmë një  
12 pushim prej një ore e gjysmë dhe do kthehemi në seancë përsëri  
13 në orën 14.30. Faleminderit për praninë dhe shpresoj që t'ia  
14 kaloni mirë për drekë.

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më dëgjoni, më dëgjoni?

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Atëherë, duke marrë udhëzime sa i  
20 takon provave të këtij dëshmitari, sepse kërkohet goxha  
21 përqendrim se janë materiale audio dhe video dhe kjo na kërkon  
22 ne që të flasim me klientin tonë poshtë dhe do na duhet  
23 gjithashtu edhe një kompjuter i lëvizshëm.

24 Nuk është një praktikë e zakonshme që avokatët mund të  
25 lejohen që të marrin kompjuterin me vete për të diskutuar me

1 klientët e tyre. Kemi kërkuar, kemi bërë një kërkesë të  
2 veçantë për këtë pushim dreke edhe doja t'jua vija në dijeni  
3 juve këtë kërkesën tonën.

4 Do donim që të na jepnit -- të kishim mundësi që të  
5 kishim me vete një kompjuter, sepse do të na ndihmonte shumë  
6 në diskutimin që do kemi me klientin tonë. Do të donim të  
7 dinim udhëzimet përkatëse lidhur me këtë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]  
9 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendojmë që  
11 mund të bëhet kjo edhe pa praninë e internetit. Mendoj që mund  
12 ta bëni me kompjuterin që keni, apo jo?

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, po pa problem. Nuk na  
14 nevojitet fare interneti. Nuk na duhet lidhja me internet.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]  
16 Po, por çështja është që nuk duam që të bëhet asnjë lloj  
17 transmetimi përmes internetit.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo, jo. Domethënë çështja është e  
19 gjitha për të shkurtuar kohën në mënyrë të tillë që të mund  
20 t'i diskutojmë përmbajtjet e videove me klientin. Kaq është.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. E  
22 kuptojmë këtë gjë.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Edhe një tjetër çështje. E kam  
24 dërguar një mesazh përmes postës elektronike ZPS-së dhe ZPS-ja  
25 në pyetjet e drejtpërdrejta për dëshmitarin thotë që ka

1 shënime për data konkrete. Dhe kam thënë tek emaili që në  
2 intervistë Prokurori thotë që i është dërguar një thirrje për  
3 të dhënë këto dokumente për intervistën.

4 Por ndërkohë i pashë dokumentet dhe fletëthirrjen ne nuk  
5 e kemi. Kështu që thjesht duhet të sqarohet kjo gjë me  
6 Prokurorinë përpara se të vazhdojmë me kundërpyetjet.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë  
8 kundërshtim?

9 Z. HALLING: [Përkthim] Jo.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të bëni  
11 përgatitjet e nevojshme gjatë pushimit të drekës dhe do  
12 vazhdojmë përsëri në orën 14.30.

13 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.06

14 --- Seanca rifillon në orën 14.30

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të  
16 vijë dëshmitari, ka disa aspekte që duhet të trajtojmë.

17 Sekretar i Gjykatës, deshët të bënit një sqarim lidhur me  
18 dokumentet që janë pranuar.

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

20 Thjesht doja të konfirmoja për procesverbal diçka lidhur  
21 me materialin SPOE0012857 deri në SPOE0012954. Që merr numrin  
22 e provës materiale P01264 dhe jo numrin e provës që i dhamë më  
23 përpara gjatë seancës.

24 Do i lutesha të na sqaronte ZPS-ja për klasifikimin sipas  
25 rregullës 154. Sepse ka disa mospërputhshmëri mes materialeve

1 të redaktuara dhe videove. Për shembull, një material është  
2 publik, dokument tjetër i redaktuar është konfidencial. Ju  
3 lutem na dërgoni një email sesi të veprojmë.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Patjetër. Ne folën dhe me Zyrën  
5 Administrative gjatë pushimit të drekës që të punojmë sa më  
6 shpejt me dokumentet që të ngarkohen sa më shpejt dokumentet  
7 në listat përkatëse në fakt.

8 Dhe po bisedonim me Zyrën Administrative që të  
9 përshpejtojmë pak procedurat për ngarkimin e dokumenteve në  
10 listat përkatëse. Ju faleminderit për ndihmën deri tani.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi  
12 Mettraux ka disa pyetje.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Z. Halling,  
14 do të doja të filloja me ju, dëshiroj t'ju pyes diçka lidhur  
15 me relevancën e pretenduar të provën materiale P1269 që është  
16 shënuar për identifikim. Unë dua të kem pak i qartë për  
17 relevancën e dokumentit. Veçanërisht, do të doja të më thoni  
18 nëse po kërkonit që ta afroni për të vërtetuar atë që ju thatë  
19 hierarkinë apo zinxhirin komandues të UÇK-së në maj të 1998,  
20 për këtë arsye po e afroni apo po e ofroni në kuadër të  
21 konfirmimit të dëshmisë së këtij dëshmitari, veçanërisht, sa i  
22 takon saktësisë të materialeve që gjenden në librin e tij apo  
23 nëse janë të dyja bashkë.

24 Me fjalë të tjera, a mund të jeni pak më konkret sa i  
25 takon relevancës së këtij dokumenti?

1           Z. HALLING: [Përkthim] Është kryesisht opsioni i parë që  
2 ju sapo përmendët. Ne kemi shumë prova për Drenocin në maj të  
3 1998 dhe rëndësinë që ka pasur ky vendi, roli që kanë pas të  
4 akuzuarit dhe kush ishte i emëruar për të drejtuar këtë vend.  
5 Unë mund t'ju jap edhe numrat e dëshmitarëve edhe numrat e  
6 provave, po ju i keni të gjitha këto.

7           Kjo është një pjesë e tërësisë së provave, plotëson  
8 tërësinë e provave. Fakti që dëshmitari ka gjetur emrin e tij  
9 në këtë periudhë kohore tregon edhe më tej që ky është  
10 dokument autentik sepse Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ka qenë  
11 në kontakt me dëshmitarë dhe një nga materialet është gjetur  
12 pikërisht në shtëpinë e njërit prej këtyre personave. Pra, kjo  
13 ka lidhje me autenticitetin e dokumentit, për këtë qëllim duam  
14 që të pranohet dokumenti.

15           GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, të njëjtën përgjigje  
16 do të kishit edhe provën materiale 1265 apo ka ndonjë  
17 relevancë tjetër kjo?

18           Z. HALLING: [Përkthim] Edhe kjo është relevante sepse  
19 është e rëndësishme për komandën e UÇK-së në atë zonë. Është  
20 një nga shënimet kryesore të UÇK-së që kemi ne, është një nga  
21 blloqet e shënimeve më të parat që ka pasur UÇK-ja që e kemi  
22 në listën e prova materiale dhe përmenden shumë ngjarje që  
23 kanë ndodhur në Likoc në maj të 1998, përfshirë stacionin e  
24 parë të polici ushtarake që është krijuar atje në maj 1998.

25           Blloku i shënimeve ka shumë detaje të rëndësishme për



1 mënyrën sesi ka funksionuar Drenica në atë periudhë kohore.  
2 Dhe fakti që dhe dëshmitari e konfirmon që shënimi lidhur me  
3 të përputhet me atë çka ka bërë ai atë kohë, ne mendojmë që  
4 është e mjaftueshme ky si kriter që dokumenti të pranohet  
5 *prima facie*, pra, e përmbush pragun për pranueshmerinë *prima*  
6 *facie*.

7 Ky nuk është i ndryshëm nga dokumentet që kemi përdorur  
8 ne me Dëshmitarin 04748, kur i treguam një bllok shënimesh  
9 dëshmitarit, ndonëse se dëshmitari s'e kishte parë më përpara,  
10 ne arritëm ta argumentonim saç duhet edhe u pranua në tërësinë  
11 e vet.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

13 Tani, z. Misetic, lidhur me kërkesën që keni bërë dje,  
14 pra që të njoftoheni për materialet sipas rregullës 103 që  
15 përdorën Gjykatësit. Tani dua të më thoni këtë: Kur na thatë  
16 që t'ju njoftojmë paraprakisht për materialet sipas rregullës  
17 102(3), unë kuptova që ju këtë e bazuat në faktin që ju nuk  
18 kishin njoftime, fare njoftim të këtyre dokumenteve sipas  
19 rregullës 102(3).

20 Sa u takon këtyre materialeve 102(3), rregulla është e  
21 ndryshme, çka do të thotë ju të gjithë i merrni materialet, të  
22 katër ekipet i merrnit materialet në fjalë.

23 Tani, për çfarë arsye doni t'ju njoftojmë ne  
24 paraprakisht? Është kjo që t'ju japim ju mundësinë të  
25 përgatiteni edhe për këto materiale apo keni ndonjë arsye

1 tjetër që doni të na e thoni?

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, është për qëllime përgatitore.  
3 Qartazi, materialet që marrim nga Prokuroria të gjitha palët e  
4 kanë një qëllim, për shembull, ju nuk do ta lejonit ZPS-në të  
5 vinte papritmas me një dokument të rregullës 102(3) dhe thotë  
6 "Oh, ky është 102(3) është bërë njoftimi paraprak dhe ne tani  
7 mund ta përdorim". Ka një qëllim dhe mbi të gjitha këtu bëhet  
8 fjalë për të drejtat e të akuzuarve.

9 Tani, Paneli i Gjykatës së Apelit, të cilin unë po  
10 përpiqem ta gjej -- dhe më jepni një minutë për këtë. Pra, ky  
11 vendim sa i takon marrjes në pyetje nga Gjykatësit në  
12 paragrafin 32 ka vendosur një kufi lidhur me pyetjen që mund  
13 të bëjë Trupi Gjykues, thotë:

14 "Pyetjet nga Trupi Gjykues mund të jenë shumë të gjera,  
15 por në këto raste këto pyetje nuk duhet të shfaqin anshmëri  
16 dhe po të cenojnë të drejtat e të akuzuarit. Po ashtu, Trupi  
17 Gjykues sigurisht nuk është i kufizuar që t'i bëjë pyetje  
18 dëshmitarëve për faktet dhe aspektet që janë trajtuar nga  
19 palët për sa kohë palët nuk cenohen dhe për sa kohë  
20 respektohen të drejtat e të akuzuarve në përputhje me nenin 21  
21 të Ligjit".

22 Pra, ne po themi tek vendimi i Apelit thuhet, për faktin  
23 që ne kemi marrë njoftimin përkatës të dokumenteve që janë në  
24 listën e ZPS-së, ne sigurisht e vlerësojmë këtë. Por nuk kemi  
25 asgjë për materialet sipas rregullës 102(3). Ne nuk e dimë

1 çfarë duam të njoftohemi që të përgatitemi kur të vijmë në  
2 sallën e gjyqit dhe të jemi të gatshëm t'ju bëjmë pyetje  
3 dëshmitarëve.

4 E vetmja kërkesë që kemi bërë ne është kjo, ne e dimë që  
5 ju përgatiteni që para se të vij dëshmitari në bankën e  
6 dëshmitarëve. Ju e dini çfarë pyetjesh do t'u bëni, kështu që  
7 do të na ndihmonit shumë ne, si ekipe të Mbrojtjes, të na  
8 thonit se çfarë materialesh keni përdorur dhe kjo jo vetëm që  
9 është e dobishme për ne por kjo respekton edhe të drejtat e të  
10 akuzuarve.

11 Z. TULLY: [Përkthim] Unë dua të përsëris kundërshtimin që  
12 përmenda më herët sa i takon bllokut të shënimeve. Z. Halling,  
13 thatë se ky është si rastet e tjera që janë përdorur me  
14 dëshmitarët si rasti 04748, sepse dëshmitari ishte në gjendje  
15 të komentonte për disa pjesë të këtij bllokut.

16 Por dëshmitari komentoj vetëm për dy rreshta në një faqe  
17 blloku. I gjithë blloku i shënimeve është shumë i gjerë dhe  
18 unë ju thashë që ka disa autorë që kanë shkruar në këtë bllok.  
19 Po ky dëshmitar ka komentuar vetëm për dy rreshta dhe nuk mund  
20 të mjaftojë komenti i tij për dy rreshta të këtij bllokut si  
21 kriter për të pranuar këtë bllok shënimesh si provë gjyqësore.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë.  
23 Faleminderit.

24 Sa i takon materialit DHT03942 deri në DHT03946, plus  
25 shqipja, Misetic, ky do të pranohet siç është kërkuar.

1 Ju lutem jepini numrin e prova materiale. Bëhet fjalë për  
2 të gjithë dokumentin.

3 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Po. Dje ne pranuan dy  
4 faqet e para që ishin me numër DHT03942 deri në DHT03943. Tani  
5 i gjithë dokumenti merr numrin 1D0155.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa i takon  
7 bllokut të shënimeve të ZPS-së, me numër SPOE00226537 deri në  
8 0026613, që ishte po ashtu i shënuar për identifikim, do ta  
9 pranojmë vetëm një faqe të këtij blloku shënimesh, që nëse e  
10 kam të drejtë mban numrin 0226545. Për pjesën tjetër të  
11 bllokut të shënimeve mund të bëni kërkesë, mund të bëni një  
12 mocion për provë jo gojore.

13 E njëjta gjë vlen edhe për materialin P01269 që është e  
14 shënuar për identifikim. Edhe për këtë material do të ruajmë  
15 të njëjtin status, bëni kërkesë dhe argumentin përkatës përmes  
16 një mocioni për provë jo gojore. Dhe besoj se kjo mjafton për  
17 momentin.

18 Në rregull. Ju lutem sillni dëshmitarin në sallë.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund ta pyes pak Prokurorinë  
20 nëse do të vazhdoj deri në fund të ditës sot, për çështje  
21 planifikimi?

22 Z. HALLING: [Përkthim] Ne po punojmë pak më ngadalë seç  
23 kishim parashikuar, mendojmë që do përfundojmë seancën e parë  
24 nesër, po sot po, sot do të punojmë gjatë gjithë pasdites.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 109

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë se u  
2 kthyet, Dëshmitar.

3 DËSHMITARI: Faleminderit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do vazhdojmë.  
5 Ju rikujtoj dhe një herë që jeni nën betim për të thënë të  
6 vërtetën sikurse vetë e lexuat në betimin solemn.

7 Pyetjet nga Prokuroria i bën z. Halling.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

9 I lutem Sekretarit të Gjykatës të vendosë në ekran  
10 materialin me numër U015-8743 deri në U015-8935, më  
11 konkretisht faqet U015-8838 në shqip dhe në anglisht. Kjo  
12 është një faqe tjetër nga libri i Jakup Krasniqit "Kthesa e  
13 madhe".

14 PY. Dëshmitar, kam disa pyetje për Bardhin e Madh që e kemi  
15 diskutuar para pushimit. Do t'ju tregoj një faqe tjetër të  
16 librit të Jakup Krasniqit. Përpara se të dali libri, a mund  
17 t'ju pyes nëse Bardhi i Madh dhe Bllasovaci janë i njëjti  
18 vend?

19 PË. Po. Bardh i Madh është në gjuhën shqipe, Bardh i madh.  
20 Bellaqec i thojnë në gjuhën serbo-kroate. I njëjti vend është.

21 PY. E kuptoj që UÇK-ja e ka pasur nën kontroll këtë zonë  
22 rreth 17 qershorit 1998, kështu?

23 PË. Po.

24 PY. Pse kishte një rëndësi kaq të madhe strategjike kjo zonë?

25 PË. Kishte një rëndësi të jashtëzakonshme strategjike për

1 arsye sepse mihja sipërfaqësore e thëngjillit në Bardh të Madh  
2 ishte mihja kryesore e nxjerrjes së thëngjillit për të  
3 prodhuar energji elektrike në termocentralet Kosova A dhe  
4 Kosova B.

5 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretarit të Gjykatës na  
6 nevojitet faqja 8838.

7 PY. Dëshmitar, ju thatë që ishte linja kryesore për prodhimin  
8 e elektricitetit, energjisë elektrike. Po atje ka një minierë,  
9 apo jo?

10 PË. Ishte, njihet po, mihja e thëngjillit. Ne i themi mihja  
11 sipërfaqësore, sepse është mihja mbi sipërfaqe. Jo nën  
12 sipërfaqe. S'është nën dhe', po mbi dhe'.

13 PY. Faleminderit. Në këtë faqe, Jakup Krasniqi ka shkruar si  
14 në vijim:

15 "... Bislim Zyrapi bëri një vlerësim profesional të  
16 Bardhit të Madh për të dhënë vlerësimin profesional për sulmin  
17 në Bardh të Madh dhe Rahovec ... dhe në të dy rastet është  
18 thënë të mos i hyjnë këtyre aksioneve se ende nuk ishin bërë  
19 përgatitjet e duhura. Pra, Shtabi i Përgjithshëm nuk ka qenë  
20 dakord të bëheshin sulmet në këto dy vende. Pasi filloj  
21 operacioni, anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm u detyruan të  
22 përfshiheshin në organizimin e luftimeve si dhe kanë qenë  
23 pjesëmarrës aktivë në luftime".

24 Dëshmitar, ju personalisht keni ndonjë dijeni për  
25 ngjarjet që ka përshkruar Jakup Krasniqi në Bardhin e Madh?

1 PË. Unë nuk mund të hyj në analizën e z. Krasniqi sepse kjo  
2 është analizë e tij. Dhe unë nuk kam qenë pjesë e Shtabit të  
3 Përgjithshëm të UÇK-së. Por si gazetar, jam informuar se  
4 ushtria Çlirimtare e Kosovës ka hyrë në minierën e thëngjillit  
5 në Bardh të Madh dhe e ka marrë nën kontroll këtë mihjen  
6 sipërfaqësore. Z. Thaçi dhe z. Veseli nuk kanë marrë pjesë në  
7 luftimet që kanë ndodhur në këtë pjesë, do të thotë, në Bardh  
8 të Madh. Por ne kemi shkuar bashkë me ekipin televiziv, me mu  
9 dhe Abaz Zekën, për të xhiruar gjendjen në të cilën ishte kjo  
10 mihje sipërfaqësore, do të thotë, ky është qëllimi kryesor i  
11 vizitës sonë bashkë me z. Thaçi dhe z. Veseli vetëm për të  
12 parë gjendjen si është atje dhe për të bërë ato imazhet të  
13 cilat i kemi bërë, për t'i transmetuar edhe në mediat botërore  
14 si i patë edhe vet agjencioni Agjencia e Lajmeve AP dhe Euro  
15 News i kanë transmetuar xhirimet që i ka bërë kameramani im  
16 Abaz Zeka.

17 E di, dua të shtoj, se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka  
18 pas vullnet të jashtëzakonshëm për të luftuar për çlirimin e  
19 Kosovës, mirëpo në atë periudhë raporti i forcave midis  
20 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ushtrisë dhe policisë serbe  
21 nuk ka qenë i favorshëm sepse, si dihet, ushtria dhe policia  
22 serbe kanë pas një potencial të jashtëzakonshëm të armatimit  
23 dhe i tërë aparati shtetëror serb është i fokusuar për të  
24 luftuar jo vetëm kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës po edhe  
25 kundër popullatës civile.

1           Ku si dihet edhe kjo ushtri dhe polici serbe, i tërë  
2 regjimi serb ka bërë më se 400 masakra mbi popullatën civile  
3 në mbarë Kosovën duke vrarë mbi 10.000 civilë shqiptarë --  
4 PY. Dëshmitar --

5 PË. -- dhe duke dhunuar 20.000 femra shqiptare.

6 PY. Dëshmitar, pyetja ime ishte më e fokusuar. A keni ndonjë  
7 arsye të kontestoni këtë që kishte shkruar Jakup Krasniqi në  
8 paragrafin që u lexova unë?

9 PË. Nuk ai që mund ta as të pohoj as të kontestoj. Për arsye  
10 sepse këto janë opinionet e tij. Dhe desha dhe unë për atë  
11 desha të them se Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk ka pas  
12 potencialet e mjaftueshme në atë periudhë për t'ju kundërvënë  
13 dhe për të mbajtur nën kontroll mihjen sipërfaqësore të  
14 Bardhit të Madh dhe Rahovecit.

15 PY. Dëshmitar, ju folët edhe për interesat e medias  
16 ndërkombëtare në këto ngjarje. Deri në ç'masë është raportuar  
17 që UÇK-ja kishte marrë nën kontroll Bardhin e madh?

18 PË. Po kjo ishte ngjarje e rëndësishme jo vetëm për mediat  
19 ndërkombëtare po dhe faktorët relevantë ndërkombëtarë,  
20 diplomatikë të botës demokratike. Ne kemi bashkëpunuar me  
21 kolegët tanë nga mediat botërore dhe disa imazhe ia kemi dhënë  
22 kolegëve tanë për t'i transmetuar dhe në mediat botërore sepse  
23 donin të krijonim opinion real, objektiv, për tërë ato që po  
24 ndodhte në Kosovë.

25           Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem të vendosni në ekran



Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 113

1 materialin ET-03-66 P233. Është një artikull i *New York Times*  
2 i 30 qershorit 1998. Ju lutem të shohim faqen e fundit me  
3 numër U008-8014.

4 PY. Dëshmitar, ju personalisht a keni lexuar ndonjë artikull  
5 në media lidhur me këtë ngjarje?

6 PË. Po, i kam parë imazhet që janë transmetuar në  
7 televizionet botërore në RNME, si në CNN, BBC, Euronews ape  
8 dhe mediat e tjera botërore.

9 PY. Në atë media keni parë të përmendet fakti që UÇK-ja ka  
10 rrëmbyer disa minatorë në Bardhin e Madh?

11 PË. Jo, nuk kam pas informacione të tilla. Aty janë zhvilluar  
12 luftime mes një njësitit të UÇK-së dhe forcave serbe dhe  
13 personelit të sigurimit serb si ka qenë në mihjen  
14 sipërfaqësore të Bardhit të Madh. Informacione më detajuese  
15 nuk kam pasur.

16 PY. Tek kjo faqja këtu përpara, *New Times* thotë kështu:

17 "Rebelët morën në kontroll një minater të madhe të  
18 thëngjillit javën e kaluar dhe rrëmbyen disa minatorë serbë  
19 dhe penguan kështu prodhimin e minierës".

20 Ju nuk e keni parë këtë në artikujt e mediave  
21 ndërkombëtare?

22 PË. Jo, s'ka pas gazeta në atëkohë, në Prishtinë s'kanë  
23 ardhë. Kjo gazetë s'ka ardhë në Prishtinë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ju  
25 lutem ngadalësoni, ju lutem, ngadalësoni pak. E dimë që e keni

1 të vështirë. Të njëjtin problem kemi të gjithë. Por  
2 përkthyesit nuk ju ndjekin dot.

3 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretarit të Gjykatës të  
4 nxjerrë në ekran materialin 101766-101767, në faqen e parë.

5 Më poshtë, ju lutem. Më konkretisht te paragrafi ku  
6 fillon këtu: "Është e paqartë ...

7 PY. Dëshmitar, po e lexoj unë, dëgjojeni përmes përkthimit,  
8 këtu flitet për Bardhin e Madh dhe ofensivën e UÇK-së dhe  
9 thuhet:

10 "Në ofensivën e kryer nga UÇK-ja rebelët kanë marrë të  
11 paktën 9 minatorë serbë peng".

12 Pra, unë po ju pyes dhe një herë, Dëshmitar, ju në mediat  
13 ndërkombëtare nuk keni lexuar asgjë të tillë që UÇK-ja ka  
14 rrëmbyer minatorë serbë?

15 PË. Jo. Nuk kam dhënë, ky informacion i detajuar nuk është  
16 dhënë. Vetëm imazhet nga mihja sipërfaqësore e Bardhit të  
17 Madh.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do t'i kërkoja Sekretarit të  
19 Gjykatës të vendosë në ekran materialin me numër 101600 deri  
20 në 101600, pra, një faqe.

21 PY. Dëshmitar, po a ke dëgjuar gjë në ndonjë formë tjetër ti  
22 që të jenë rrëmbyer minatorë serbë, nuk po flas tani për  
23 mediat ndërkombëtare, po në ndonjë formë tjetër ke dëgjuar  
24 gjë?

25 PË. Nuk kam dëgjuar as atëherë as deri sot nuk kam dëgjuar.

1 PY. Pra, këto që ju lexova unë ju tani nga këto artikuj ju i  
2 dëgjoni për herë të parë?

3 PË. Për herë të parë.

4 PY. Në fillim të këtij artikulli që është *The Times*, 2 korrik  
5 1998, thotë:

6 "Nëntë pengje serbe që mbahen të ndaluar që u morën nga  
7 Ushtria Çlirimtare e Kosovës besohet se janë vrarë pasi forcat  
8 serbe rimorën nën kontroll mihnën e rëndësishme të thëngjillit  
9 e cila më parë ishte marrë nën kontroll nga rebelët  
10 shqiptarë."

11 Pra, ju nuk keni dëgjuar asgjë që këta persona të jenë  
12 vrarë nga Bardhi i Madh -- këta persona nga Bardhi i Madh të  
13 jenë vrarë?

14 PË. Unë ju thashë, po po e përsëris. Nuk kam dëgjuar as  
15 atëherë as deri më sot nuk kam dëgjuar për këtë.

16 PY. Dëshmitar, unë po ju them që të gjithë e dinë që media  
17 ndërkombëtare e ka raportuar këtë incident dhe nëse kjo ka  
18 dalë në mediat ndërkombëtare, nuk ka mundësi që diçka e tillë  
19 të mos jetë parë. Ti si i përgjigjesh kësaj, ky pretendim i  
20 tillë.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Më falni që po ju ndërpres. A mund  
22 të flasim pak, të na thotë Prokurori çfarë relevance kishte  
23 kjo? Sepse po përpiqem ta gjej në dosjen paragjyqësore ku  
24 është përmendur kjo.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të marrim

1 fillimisht përgjigjen e dëshmitarit.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Njoftimi i të akuzuarve nëse ka  
3 ndodhur, nëse ka kryer krime UÇK-ja është çështje që qendrore  
4 në këtë gjykim. Dhe njësoj si rasti i ofensivës së Rahovecit  
5 që ka ndodhur shkurtimisht pas ngjarjeve në Bardhin e Madh  
6 ekzistojnë shumë pretendime që janë kryer krime nga UÇK-ja në  
7 këtë zonë dhe janë kryer në fillimin e periudhës kohore të  
8 ngritur në aktakuzë edhe vetë dëshmitari e ka vërtetuar dhe ka  
9 thënë që dhe ne themi që UÇK-ja ka qenë në gjithë këto zona  
10 gjatë gjithë periudhës kohore të përmendur në aktakuzë.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Po ne po ju themi pra, që nuk  
12 është e përmendur kjo në aktakuzë, ky incident konkret nuk  
13 është i përmendur në aktakuzë. Nuk jemi njoftuar ne si  
14 Mbrojtje siç duhet sa i takon faktit që është hetuar ky  
15 incident dhe ata po përpiqen që të përfshijnë drejtpërdrejt të  
16 akuzuarit në një incident të papërmendur në aktakuzë. Ky është  
17 një njoftim i papërshtatshëm që bën z. Halling.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë dua ta vërtetoj z. Halling që  
19 është kryer krimi dhe të vërtetoj që udhëheqja ka pasur  
20 njohuri dhe ka pasur autoritetin për t'i parandaluar dhe  
21 ndëshkuar krime të tilla dhe më pas të flasim për relevancën  
22 parimisht.

23 Tani këtu në këtë rast këtu kanë disa pretendime. Asnjë  
24 provë s'ka Prokuroria që ka ndodhur kjo. Këto janë thjesht  
25 pretendime. Dhe të thuash të pranojmë artikuj gazete për

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 117

1 vërtetësinë e krimit që kanë ndodhur krime kjo është absurde  
2 sepse kjo s'është në aktakuzë, këto janë copa gazete, kjo nuk  
3 është aspak e logjikshme.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

5 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

7 [Përkthim] Atëherë materiali që po diskutohet nuk mund të  
8 përdoret në këtë pikë me këtë informacion që kemi për të  
9 provuar vërtetësinë e fakteve që përfshihen në të, megjithatë  
10 mund të lidhet me besueshmërinë e këtij dëshmitari, kështu që  
11 për këtë arsye do ta pranojmë këtë material.

12 Z. HALLING: [Përkthim] faleminderit, të nderuar Gjykatës.

13 Atëherë --

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk isha

15 shumë i qartë besoj por kundërshtimi rrëzohet.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Po, e kuptova, megjithatë  
17 domethënë, dëshmitari nuk pati mundësi që t'i përgjigjet asaj  
18 çfarë unë parashtrova.

19 PY. Do që ta përsëris edhe një herë parashttrimin tim,  
20 Dëshmitar, në mënyrë që të kesh mundësi që t'i përgjigjesh?

21 PË. Z. Prokuror, unë ju përgjigja tri herë. Nuk kam pas  
22 informacion as atëherë as deri sot. Të lutem mos më provoko më  
23 tepër.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, të  
25 lutem përpiku që të japësh përgjigje pyetjeve që të bëhen.

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 118

1 Sepse mund të ketë edhe palë të tjera të cilat mund t'ju bëjnë  
2 pyetje të tjera plotësuese për të njëjtën temë.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Përgjigja e dëshmitarit është  
4 përgjigja e dëshmitarit nuk është e nevojshme që ta përsëris  
5 edhe një herë tjetër. Megjithatë mendoj që qëndrimi jonë është  
6 shumë i qartë.

7 Duke pasur parasysh që ne jemi lejuar që të përdorim këto  
8 dokumente, duke merre parasysh vendimin tuaj, të nderuar  
9 Gjykatës, do kërkojmë që artikujt e medias të pranohen si  
10 prova materiale. Bëhet fjalë për dokumentet e identifikuar  
11 IT-03-66 P233 dhe 101766-101767 dhe 101600 deri në 101600.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] IT-03-66 P233  
13 --

14 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më fal.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Jam kundër absolutisht kundër. Dhe  
17 në fakt vendimin e mëngjesit ju thashë që po i lejoni pyetjet  
18 për arsye besueshmërie.

19 Megjithatë Prokuroria mbështetur në rregullin 143, nuk  
20 lejohet që të përdorë materiale për diskreditimin e  
21 dëshmitarëve të vet. Sepse në nënpikën 1 ose paragrafin 1  
22 është shumë e qartë thuhet shprehimisht që në qoftë se ka një  
23 deklaratë të mëparshme jokonsistente atëherë mund të vazhdohet  
24 me diskreditimin e dëshmitarit. Dhe në fakt nuk ka asnjë lloj  
25 mungese konsistence me dëshmitë e dëshmitarit më herët.

1 Kështu që qëndrimi ynë është që ky dokument nuk mund të  
2 pranohet.

3 Kështu që 143 është *lex specialis* dhe mund të përdoret  
4 vetëm sa i takon kundërshtimit ose tezës që dëshmitari është i  
5 pabesueshëm.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
7 Atëhere në qoftë se nuk keni gjë tjetër për të thënë nuk është  
8 e nevojshme që të përsërisni qëndrimin tuaj të mëparshëm.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në rregull.

10 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'i caktoj  
12 një numër provizor prove materiale dhe pastaj do të marrim  
13 vendimin.

14 Z. Halling, vazhdoni.

15 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për  
16 ta sqaruar në qoftë se e kam kuptuar siç duhet, do i caktojmë  
17 një numër provizor prove materiale dokumenteve që përmendët,  
18 apo jo?

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

20 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull. Dokumenti  
21 IT-03-66 P233 do të marrë numrin provizor të provës P01724 dhe  
22 do klasifikohet si publik.

23 Ndërkohë dokumenti 101766 deri në 101767 do të marrë  
24 numrin provizor të provës P01275 aktualisht ka klasifikimin  
25 konfidencial.

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 120

1 Dokumenti me ERN101600 deri në 101600 do të marrë numrin  
2 provizor të provës P01276. Aktualisht është i klasifikuar si  
3 konfidencial. Ju faleminderit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë  
5 arsye pse këto dokumente duhet të klasifikohen si  
6 konfidencial?

7 Z. HALLING: [Përkthim] Jo.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
9 Do i klasifikojmë si publik.

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull. E mbajtëm  
11 shënim.

12 Z. HALLING: [Përkthim] E vetmja gjë që duam të theksojmë  
13 për sa i takon aspektit ligjor është që sigurisht ne i kemi  
14 marrë leje më përpara për t'i marrë në pyetje dëshmitarët për  
15 çështje që, megjithëse ata thonë që nuk e dimë apo nuk na  
16 kujtohet, janë tregues që në fakt atyre ju kujtohet ose dinë  
17 kanë dijeni lidhur me pyetjet. Dhe e vërteta është që rregulli  
18 143, ndryshe nga ajo që parashikohet nga Mbrojtja, më  
19 konkretisht rregulla 143, paragrafi 2(b) lejon bërjen e  
20 pyetjeve për dëshmitarin lidhur me besueshmërinë e tij "për  
21 çështje për të cilat dëshmitari mendoj që të ketë njohuri".

22 Dhe jo vetëm kaq, po ju, të nderuar Gjykatës, keni marrë  
23 dhe një tjetër vendim të mëparshëm që është në përputhje me  
24 këtë linjë që sapo shpjegova.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.



1 Do marrim një vendim më vonë lidhur me këtë pikë.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Ne gjithashtu kemi përdorur një  
3 tjetër faqe të librit të Jakup Krasniqit. Kemi përdorur një  
4 faqe të dytë në seancën e mëparshme. Është një libër që është  
5 pranuar pjesërisht si provë. Besoj se bëhet fjalë për provat  
6 që aktualisht kanë numrat P189, P729, P765, megjithatë  
7 kapitujt në të cilat janë ose përfshihen faqe të tilla nuk  
8 janë të pasqyruar plotësisht në prova.

9 Kështu që për çështje qartësie, do kërkonim që të  
10 pranohet si prova edhe faqet që përfshihen në U015-8828 nga  
11 gama më e madhe ose më e plotë e faqeve të librit, pra,  
12 kërkojmë që të pranohet dhe këto faqen në mënyrë që të tillë  
13 që të kuptohet i gjithë konteksti.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
15 kundërshtim për pranimin e këtij materiali?

16 DËSHMITARI: Z. Gjykatës, të lutem.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, tani, jo  
18 tani, Dëshmitar.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

20 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

21 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ne kërkojmë që të pranohen  
22 vetëm ato faqe që ju treguan dëshmitarit, jo faqe tjera.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo është arsye që pse po kërkoj  
24 që të pranohen në prova faqe të tjera, në mënyrë të tillë që  
25 konteksti të jetë më i plotë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
2 U015-8828 deri në U015-8841 pranohet në provë materiale.

3 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e  
4 provës P01277. Ju faleminderit.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

6 PY. Dëshmitar, tani do të kalojmë në një temë tjetër. Do të  
7 flasim për ceremoninë e betimit të UÇK-së që e përshkruani në  
8 librin tuaj që është regjistruar më datë 26 qershor 1998.  
9 Përpara sesa të flasim për këtë ceremoni, do ju pyes se çfarë  
10 keni bërë një ditë më përpara kur keni filmuar në Luzhnicë më  
11 25 qershor 1998. Kjo pasqyrohet në faqen 270 të librit tuaj  
12 deri në faqen 272 të të njëjtit libër.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të  
14 paraqesë në ekran dokumentin 061427 deri në 27 dhe përkthimin  
15 përkatës në anglisht.

16 PY. Dëshmitar, ndërkohë që paraqitet ky dokument, dua t'ju  
17 pyes a keni bërë intervista në Luzhnicë më 25 qershor 1998?

18 PË. Po, kam bërë. Po para se të flas për këtë, desha të  
19 konstatoj se dokumenti që prezantua këtu për mihjen  
20 sipërfaqësore në Bardh të Madh, nuk më është prezantuar deri  
21 në këtë moment mu gjatë bisedave me Prokurorin Matt. Ky është  
22 një provokim i papranueshëm për mue që të qes në lajthitje  
23 para Trupit Gjykses dhe para opinionit. Ai dokument për herë  
24 të parë unë e pash sot.

25 PY. Dëshmitar, si dëshmitar nuk është roli juaj që të

1 vendosni në qoftë se një dokument do të pranohet si provë apo  
2 jo. Ju lutem dëgjoni pyetje dhe jepini përgjigje.

3 Shikojmë një person në ekran. Kush është ky personi që  
4 është në ekran?

5 PË. Po më 25 qershor të vitit 1998 në Luzhnicë kam  
6 intervistuar z. Bislum Zyrapi, i cili ka qenë shef i shtabit  
7 operativ të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe z. Agim Qelaj,  
8 një oficer karriere i cili ka qenë një ndër oficerët më të  
9 mirë që ka pasur Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

10 PY. Cili prej këtyre personave është ky që kemi përpara në  
11 ekran, kush është ky personi?

12 PË. Bislum Zyrapi.

13 PY. Faleminderit.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që ta  
15 transmetojë nga këtu ku jemi deri në 01:07.

16 [Luhet videoincizimi]

17 [Zëri] "Unë jam epror ushtarak i shkolluar në shkollat  
18 ushtarake po dhe në përvojat e luftërave të cilat kanë qenë më  
19 para. Ne eprorët ushtarakë në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës  
20 jemi të angazhuar në të gjitha strukturat e ushtrisë  
21 Çlirimtare të Kosovës për aftësimin e eprorëve dhe ushtarëve në  
22 kuadër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjatë ushtrimit të  
23 cilit ne i ushtrojmë ushtarët dhe eprorët jemi shumë të  
24 pasionuar me aftësinë dhe shpejtësinë të cilët ushtarët dhe  
25 eprorët në kuadër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilët

1 aftësohen dhe aq shpejt dhe janë të përgatitur për nevojat e  
2 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por edhe në për nevojat e  
3 betejës apo të luftërave të cilat zhvillohen në territorin e  
4 Kosovës”.

5 PY. Tani, Dëshmitar, përpara se t’ju bëj pyetjen.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoj Sekretarit që të  
7 paraqesë në ekran një tjetër dokument që është 061427-26 dhe  
8 përkthimin në anglisht të të njëjtit dokument.

9 Ndërkohë që paraqitet ky dokument, dua t’ju bëj një  
10 kujtesë që ma transmetuan përpara pushimit të drekës. Një  
11 pjesë e videove që po shohim sot nuk po transmetohet për  
12 publikun. Megjithatë, unë e thashë edhe sot më herët paradite,  
13 që sa i takon fragmenteve për të cilat unë ka kërkuar  
14 transmetimin këto janë fragmente që mund të shikohen nga  
15 publiku. Kështu që do kërkoja dhe një herë tjetër që videoja  
16 të transmetohet për publikun.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Trupi Gjykses  
18 pajtohet me këtë.

19 Z. HALLING: [Përkthim]

20 PY. Dëshmitar, ndërkohë që paraqitet transkripti, a mund të  
21 na thoni kush është ky person?

22 PË. Po. Ky është gjeneral Agim Qelaj.

23 PY. Edhe ky person është nga Luzhnica më 25 qershor 1998?

24 PË. Jo, nuk është nga Luzhnica. Është me prejardhje nga  
25 Stellci i Deçanit, ka jetuar një kohë në Pejë dhe në perëndim

1 në Gjermani ju ka bashkangjitur Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës  
2 nga Gjermania dhe ka qenë epror ushtarak i UÇK-së. Por  
3 intervista është zhvilluar në Luzhnicë.

4 PY. Në rregull. Më kuptuat atëherë. Dhe kjo ka ndodhur më 25  
5 qershor edhe kjo në vitin 1998 intervista e kam fjalën?

6 PË. Po, po.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që të  
8 transmetojë tani nga këtu deri në sekondën e 24.

9 [Luhet videoincizimi]

10 [Zëri] "Jam ushtarak i Ushtri Çlirimtare të Kosovës. Me  
11 fillimin e luftës në territorin e Republikës së Kosovës jam  
12 kthyer nga perëndimi dhe jam kyç në radhët e Ushtri Çlirimtare  
13 të Kosovës që ta kryej atë barrë që e kam si shqiptar dhe  
14 qytetar i Kosovës ndaj kësaj toke dhe ndaj këtij populli.  
15 Është një karakteristikë kur ka mbërri këtu. Shifet një  
16 vullnet i madh tek popullata civile dhe tek pjesëtarët e UÇK-  
17 së. Është karakteristika tjetër se një pjesë e mirë e rinisë  
18 sonë nuk e kanë krye shërbimin ushtarak. Mirëpo me vullnetin që  
19 e kanë dhe me angazhimin tonë maksimal ajo mungesë  
20 kompensohet. Kështu që niveli i gatishmërisë të forcave tona,  
21 të njësiteve tona të cilat gjinden ..."

22 Z. HALLING: [Përkthim] U ndërpre fjala e fundit e  
23 përkthimit, megjithatë mjafton për transkript.

24 Të nderuar Gjykatës, do kërkojmë që këto dy video të mund  
25 të pranohen si prova, më konkretisht bëhet fjalë për

1 dokumentin 061427-46 që është videoja e z. Qelaj dhe pastaj  
2 kemi dhe videon tjetër të Bislam Zyrrapit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe  
4 transkriptet apo jo?

5 Z. HALLING: [Përkthim] Po, e vërtetë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
7 kundërshtime?

8 PËRKTHYESI: Ekipet e Mbrojtjes nuk kanë kundërshtime.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] dokumenti  
10 061427-27, plus transkriptin në anglisht, pranohen si prova.  
11 Ju lutem caktojini një numër.

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e  
13 provës P01278. Të nderuar Gjykatës, aktualisht ka klasifikimin  
14 konfidencial si videoja ashtu edhe transkriptet.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Klasifikoi si  
16 publike.

17 Në rregull. Dokumenti 061427-26, plus transkriptin në  
18 anglisht pranohen dhe do të marrin numër prove materiale.

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Numri i provës është  
20 P01279. Klasifikimi është konfidencial.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]  
22 Riklasifikoheni si publik.

23 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
25 vazhdoni, Prokuror.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Videoja tjetër që kërkoj që të  
2 paraqitet është 061427-25 dhe përkthimi në anglisht dua që të  
3 transmetohet po ashtu, ndërkohë që kërkoj që të filloj nga  
4 minuta e parë deri në sekondën e 52.

5 PY. Ndërkohë që Sekretari e nxjerrë këtë dokument në ekran,  
6 dëshmitar, dua që t'ju pyes lidhur me ceremoninë e betimit për  
7 të cilën ju flisni në faqen 272 deri në 273 në librin tuaj.

8 Ne diskutuam ose folëm për këtë fushën në Kleçkë. Dua  
9 t'ju pyes tek ajo fusha në Kleçkë e keni bërë regjistrimin e  
10 ceremonisë së betimit?

11 PË. Po, në Kleçkë, më 26 qershor të vitit 1998.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Do kërkoja që të kalojmë tek  
13 videoja në 01:52. Që është faqja 2 e transkriptit në anglisht.

14 Do i lutesha Sekretarit që të bëjë transmetimin e videos  
15 nga minuta 1:55 deri në 2:02.

16 [Luhet videoincizimi]

17 Z. HALLING: [Përkthim]

18 PY. Kjo është ceremonia e betimit, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Nga e majta në të djathtë në këtë fotografi a mund të na  
21 thoni kush janë këto persona?

22 PË. Është komandant Musë Jahsari, komandant Fatmir Limaj dhe  
23 komandant Ismet Jashari, Kumanova.

24 PY. Faleminderit.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që të na

1 transmetojë tani nga minuta 02:02, pastaj nga deri në minutën  
2 06:13 dhe në fakt është videoja më e gjatë që kërkojmë që të  
3 transmetohet.

4 [Luhet videoincizimi]

5 [Zëri] "Ushtarë dhe oficerë, nderime.

6 "Nderim.

7 "Gati tu!

8 "Përshëndetje! Ngritjes së flamurit!

9 "Gati tu!

10 "Si pjesëtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, betohem  
11 se do të luftoj për çlirimin e tokave të pushtuara të  
12 Shqipërisë dhe bashkimin e tyre. Do të jem përherë ushtar  
13 besnik, luftëtar i denjë i lirisë, vigjilent, guximtar dhe i  
14 disiplinuar, i gatshëm që në çdo kohë pa kursyer as jetën  
15 time, të luftoj për t'i mbrojtur interesat e shenjta të  
16 atdheut. Nëse e shkel këtë betim, le të ndëshkohem me ligjet  
17 më të ashpra të luftës. Dhe nëse tradhtoj qoftë i humbur gjaku  
18 im. Betohem!

19 "Si pjesëtar i Ushtri Çlirimtare të Kosovës, betohem se  
20 do të luftoj për çlirimin e tokave të pushtuara të Shqipërisë  
21 dhe bashkimin e tyre. Do të jem përherë ushtar besnik,  
22 luftëtar i denjë i lirisë, vigjilent, guximtar dhe i  
23 disiplinuar, gatshëm që në çdo kohë, pa kursyer as jetën time,  
24 të luftoj për t'i mbrojtur interesat e shenjta të atdheut.  
25 Nëse e shkeli këtë betim, le të ndëshkohem me ligjet më të



1 ashpra të luftës. Dhe nëse tradhtoj, qoftë i humbur gjaku im.  
2 Beto hem!"

3 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, Sekretar i Seancës.

4 Në këtë video ka dhe një pjesë tjetër të shkurtër që  
5 kërkoj që të transmetohet. Është më përpara në video, nuk ka  
6 fare tekst, nuk ka zë. Kështu që do kërkoja që të transmetohet  
7 nga sekonda e 5 deri në sekondën e 17 dhe ju lutem ngrijeni  
8 pamjen në sekondën e 17, Sekretar.

9 [Luhet videoincizimi]

10 Z. HALLING: [Përkthim]

11 PY. Dëshmitar, a është kjo pamje e UÇK-së që bëni biseda,  
12 diskutime përpara se të bëhej regjistrimi i ceremonisë së  
13 betimit në datë 25 qershor 1998?

14 PË. Jo, kjo ishte në pauzë të xhirimeve, sepse ishte një  
15 moment shumë i rëndësishëm xhirimi i betimit solemn të  
16 ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ishte situatë  
17 e rëndë sepse kishte vetëm një kamerë të vogël, nuk kishim  
18 disa kamera që praktikohet të xhirohet nga disa kënde dhe me  
19 mikrofon, kështu që vetëm me një kamerë, kështu që kemi pas  
20 nevojë bashkë me kameramanin që të bëjmë pauzë dhe bashkë me  
21 luftëtarët e UÇK-së që jepnin betimin. Kjo ka qenë gjatë  
22 pauzës së xhirimit të betimit.

23 PY. Mendoj që është e qartë nga përgjigja që dhatë, po për  
24 procesverbal, kjo ka ndodhur në Kleçkë përsëri më 25 qershor  
25 1998, kështu, Dëshmitar?

1 PË. Në Kleçkë më 26 qershor, jo më 25 qershor, po në 26  
2 qershor 1998.

3 PY. E kuptova. Tani ky zotëria që është me këmishë të bardhë  
4 diku nga mesi i kësaj fotografie që është ulur tek ky  
5 grumbulli i njerëzve, kush është ky personi?

6 PË. Ky zotëria është Nuhi Bytyqi, gazetari. Do të thotë, unë  
7 jam.

8 PY. Po personi që është në të majtën tuaj, kush është?

9 PË. Është z. Hashim Thaçi. Pastaj është Xhavit Ferizi,  
10 Raketa, është z. Kadri Veseli, z. Fatmir Limaj, Musa Jashari  
11 dhe Ismet Jashari, komandant Kumanova. Anash majtas janë edhe  
12 disa luftëtarë të tjerë po nuk po i dalloj saktësisht kush.

13 PY. Faleminderit.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit tani që të  
15 paraqesë në ekran dokumentin 061427-21. Nuk ka transkript për  
16 këtë dokument pasi nuk dëgjohet fare pjesa audio.

17 DËSHMITARI: Audio dëgjohet. Dëgjohet një këngë që  
18 këndohej gjatë periudhës së luftës nga luftëtarët e UÇK-së,  
19 ishte një këngë që ishte një lloj himni për luftën çlirimtare.

20 Z. HALLING: [Përkthim]

21 PY. I takon që e dite që çka do tregoj unë më pas, kështu që  
22 do i kërkoja Sekretarit që ta transmetojë këtë video që është  
23 e vërtetë që ka një këngë, këndohet një këngë aty dhe kërkoj  
24 që ta transmetoni.

25 [Luhet videoincizimi]

1 Z. HALLING: [Përkthim]

2 PY. Dëshmitar, e keni marrë juve këtë filmin?

3 PË. Ky është xhirimi që ka bërë kolegu Abaz Zeka.

4 PY. Kur është filmuar kjo, Dëshmitar?

5 PË. Kjo është në fshatin Banjë të komunës së Malishevës. Ka  
6 qenë dasma e luftëtarit të UÇK-së Naser Krasniqit, me  
7 pseudonimin Bashkim Fino. Do të thotë, atë ditë më 26 qershor  
8 të vitit 1998, pikërisht në ditën kur është bërë betimi solemn  
9 në Kleçkë. Kjo është një dasmë edhe ishte rasti i parë që  
10 gjatë periudhës së luftës kisha dëgjuar se një luftëtar i UÇK-  
11 së martohet dhe ishte një simbolikë shumë pozitive, shumë e  
12 rëndësishme se dhe në kohë lufte luftëtarët e UÇK-së martohen  
13 dhe ishte një sinjal se populli shqiptar do të rritet, do të  
14 triumfojë lufta çlirimtare dhe luftëtarët e UÇK-së,  
15 bashkëluftëtarët e Naserit organizuan, qysh morën pjesë në  
16 këtë dasmë.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë do i kërkoja Sekretarit që  
18 të kalojmë tek pjesa tjetër, ta transmetojë deri në sekondën e  
19 27 dhe pastaj ta ngrijë.

20 PY. Do më duhet që të më ndihmoni për identifikimin e disa  
21 personave që kanë marrë pjesë në këtë ngjarje, Dëshmitar.

22 Kush janë këta dy personat që kemi në ekran nga e majta  
23 në të djathtë, si i kanë emrat?

24 PË. Ky është komandant Shukri Buja dhe Naser Krasniqi, i cili  
25 martohet atë ditë.

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 132

1 PY. A e dini se çfarë nofke ka pasur Naser Krasniqi gjatë  
2 luftës?

3 PË. Po, Bashkim Fino.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do i kërkoja Sekretarit të  
5 kalojmë tek sekonda e 34.

6 PY. Përsëri nga e majta në të djathtë kush janë këta persona  
7 me emër?

8 PË. Nga e majta në të djathtë është Fatmir Limaj, Kadri  
9 Veseli dhe Musa Jashari.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe në fund, të shohim sekondën e  
11 44.

12 PY. Edhe një herë, ju lutem, nga e majta në të djathtë cilët  
13 janë këta persona}?

14 PË. Është Xhavit Ferizi, komandant Raketa, z. Hashim Thaçi  
15 dhe unë.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që  
17 të pranohet si provë gjyqësore pjesa e ceremonisë së betimit  
18 në videon që e kemi ngarkuar në listën tonë të prezantimeve  
19 dhe që mban numrin 061427-25 dhe më konkretisht na nevojitet  
20 segmenti që ne transmetuam dhe na nevojitet edhe videoja e  
21 ditës së martesës së Naser Krasniqit në të njëjtën ditë që  
22 është me numër 061427-21.

23 Dëshiroj t'ju them që ne jemi përpjekur që të pranohet  
24 kjo video në gusht të 2023 në një nga seancat gjyqësore e atij  
25 muaji, mirëpo nuk u pranua sepse dëshmitari në fjalë nuk

1 kishte marrë pjesë në ceremoninë e betimit, kështu që ne nuk  
2 arritëm që ta përfshinim këtë provë te provat gjyqësore.  
3 Besojmë se tani i kemi trajtuar të gjitha aspektet e nevojshme  
4 dhe se videoja duhet pranuar.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
6 kundërshtime?

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka kundërshtimi.

8 PËRKTHYESI: Ekipet e Mbrojtjes nuk kanë kundërshtime.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të dy  
10 dokumentet pranohen dhe do të marrin numrin e provës  
11 materiale.

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Materiali  
13 061427-25 merr numrin e provën materiale P01280, është  
14 konfidencial, bashkë me transkriptin përkatës.

15 Ndërsa materiali 061427-21 merr numrin e provës 01281  
16 edhe transkripti si në shqip dhe në anglisht është i  
17 klasifikuar si konfidencial.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
19 Bëjmë dhjetë minuta pushim.

20 Z. TULLY: [Përkthim] Do të doja të thoja diçka  
21 shkurtimisht jo tani, po mbase pas pushimit ose në fund të  
22 ditës, do të doja të flisja diçka për parashtrimin që bëri z.  
23 Halling për faktin që duhet të mbështet në rregullën 143(2)(b)  
24 për pranimin e artikullit të *New York Times*.

25 Nuk dua të fillojmë dhe një herë debatin për këtë vendim,

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 134

1 megjithatë do të donim të bënim një parashtim nga ana jonë  
2 dhe kjo të jetë e zbardhur në procesverbal.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
4 Po nuk do ta bëni tani.

5 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
7 Bëjmë dhjetë minuta pushim.

8 --- Seanca ndërpritet në orën 15.32

9 --- Seanca rifillon në orën 15.41

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
11 z. Tully.

12 Z. TULLY: [Përkthim] Faleminderit. Shumë shkurt desha të  
13 thojë diçka.

14 Z. Halling përmendi rregullën 143(2)(b) si bazën për  
15 pranimin e dokumentit që i paraqiti dëshmitarit.

16 Tani, nuk diskutohet që rregulla 143(2)(b) në të vërtetë  
17 -- unë do ta lexoj. Në fakt çfarë thotë kjo rregull, thotë "me  
18 autorizim të Trupit Gjykes pala thirrëse e një dëshmitari  
19 mund ta pyes dëshmitarin për sa i përket më poshtë në qoftë se  
20 ka lidhje me besueshmërinë e dëshmitarit për një çështje për  
21 të cilën logjikisht mund të supozohet se dëshmitari ka dijeni  
22 dhe për të cilën sipas Trupit Gjykes, kur pyetet për një  
23 pale, dëshmitari nuk bën përpjekje të njëmendta për të  
24 dëshmuar".

25 Tani, rregulla 143(2)(c) thotë: Nëse dëshmitari ka dhënë

1 në çfarëdo kohe një deklaratë të mëhershme mospërputhëse.

2 Pra, në bazë të rregullës 143(2)(c) mund të pranohet. Kjo  
3 është e shpjeguar vetë në rregull. Ama 143(2)(b) nuk mund të  
4 jetë baza ligjore për pranimin e dokumentit siç u përpoq ta  
5 justifikonte z. Halling.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe unë doja ta ngrija këtë, është  
7 *lex specialis*. E vetmja pjesë e kësaj dispozite që lejon  
8 pranimin e dokumentit për diskreditimin e vet dëshmitarëve të  
9 palës është pjesa (c), pra, rregulla 143(2)(c) dhe lidhet  
10 vetëm me një deklaratë të mëhershme mospërputhëse.

11 Mos të hyjmë tani përkufizimit çfarë është deklarata e  
12 mëhershme mospërputhëse, po këto janë artikuj gazete, nuk mund  
13 të konsiderohen këto deklarata të mëparshme mospërputhëse.  
14 Kështu që nuk i përmbushin kriteret.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull. Po rregulla 138?

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë po ju them që është *lex*  
17 *specialis*. S'ka pse të merret fare parasysh rregulla 143(2)(c)  
18 nëse marrim parasysh rregullën 138 këtu.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po rregulla 138, paragrafi 2  
20 (a) dhe (b), të dyja pikat a dhe b, nuk flasin vërtetë për  
21 deklaratat e më hershme mospërputhëse por problemi për të  
22 pranuar dokumentet sipas rregullës 138, është fakti që s'ka  
23 *lex specialis*?

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Por duhet parë në tërësi e gjithë  
25 rregulla. Rregulla dhe përcakton rrethanat dhe kufizon

1 rrethanat kur mund të diskreditohet dëshmitari.

2 Tani, Trupi Gjykses ka marrë vendim që ky material, mund  
3 të merret parasysh dhe të pranohet vetëm për qëllime  
4 besueshmërie, që sipas përkufizimit kjo do të thotë do të  
5 merret vetëm për qëllimet për diskreditimin e dëshmitarit.

6 Tani, 138 është pak më e gjerë dhe mbulon forma të ndryshme  
7 sesi palët mund të diskreditojnë dëshmitarët e tyre, pra, në  
8 thelb, ne mendojmë që rregulla 143 është rregulla e duhur.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nëse po e kuptoj unë siç  
10 duhet, ju po thoni që natyra *lex specialis* e rregullës  
11 143(2)(c), fjalia e dytë -- nuk gjendet vetëm në fjalinë e  
12 dytë por është në të gjithë rregullën, këtë po thoni?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Pra, përshkruan, përkufizon  
14 kufijtë e rrethanave kur një palë mund ta ndihmojë dëshmitarin  
15 t'i rifreskojë kujtesën ose mund ta diskreditojë dëshmitarin e  
16 vet. Unë nuk e kuptoj dot nëse mund të shfrytëzojmë rregullën  
17 138 për diskreditimin e dëshmitarit.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Misetiç, nuk dua të bëjmë  
19 litigime të thelluara tani.

20 Por me sa më kujtohet mua rregulla 143, paragrafi 2 ka dy  
21 fjali këtu. Paragrafi 2, është edhe tek germa (c), e vetmja  
22 fjali që flet për pranimin e provave ose deklaratave të  
23 mëhershme mospërputhëse është fjalia e dytë siç thatë ju, pra,  
24 është në germën (c). Dhe besoj, ju me të drejtë e thatë që të  
25 gjithë opsionet e tjera që mbulon 143(2) lidhen me



1 besueshmërinë e dëshmitarëve dhe me të drejtat apo opsionin  
2 për të pyetur dëshmitarët dhe nuk trajtojnë pranimin e  
3 provave.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Por shikoni fjalinë e dytë të  
5 pikës (c) dhe fillojmë duke marrë parasysh faktin që rregulla  
6 138 lejon diskreditimin e dëshmitarëve, po prezumojmë që këtu  
7 duhet të ishin përfshirë dhe deklaratat e mëhershme  
8 mospërputhëse. Kështu që nëse donim të merrnim parasysh  
9 deklaratat e mëhershme mospërputhëse, për çfarë e kanë shtuar  
10 autorët e rregullës këtë fjali këtu në këtë dispozitë?

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kam dy pyetje për *lex*  
12 *specialis*. Pra, kur thoni ju 143(2)(c) është disa  
13 kontroversiale apo duhet pranuar një deklaratë e mëhershme  
14 mospërputhëse për qëllimin e vërtetësisë së përmbajtjes dhe  
15 çfarë do të thonit ju për parashtrimin tim dhe për nocionin që  
16 fjalia e 143(1) thotë që:

17 "Pala pyetëse mund t'i bëjë pyetje dëshmitarit dhe t'i  
18 tregoj çfarëdo dokument apo provë tjetër dëshmitarit në  
19 përputhje me rregulloren".

20 Sepse ky është rasti ynë, pala që po bën pyetjet po i  
21 tregon dëshmitarit një dokument jo një deklaratë të mëhershme  
22 mospërputhëse.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Pra, po e filloj dhe një herë, po  
24 e marr nga ana tjetër. Fjalia e parë është një përkufizim i  
25 gjerë që nuk lidhet me diskreditimin. Mund t'i tregosh

1 dëshmitarit çfarëdo dokument thotë këtu.

2 Ama zërthehet më tej dhe thotë, kur duam ti tregojmë  
3 fakte dhe kur jep leje Trupi Gjykues. Tani ne duhet të  
4 kuptojmë çfarë interpretohet në këtë rregull. Sepse nëse  
5 eliminojmë fjalinë e parë, atëherë nuk do ishte nevojë fare që  
6 të kërkohet leje për rifreskim e kujtesës apo për  
7 diskreditimin e dëshmitarit, pra, duke u zërthyer më tej ka  
8 edhe kufizime se çfarë pyetjesh mund t'i bëhen dëshmitarit,  
9 çfarë mund t'i paraqitet dëshmitarit.

10 Tani sa i takon rregulle 143(2)(c). Nëse kjo rregull  
11 kishte për qëllim të lejonte përdorimin e një deklaratë të  
12 mëhershme mospërpputhëse -- unë e di që kjo është një  
13 dispozitë është ndryshuar nga një version i mëhershëm i  
14 rregullores, dua të shikoj formulimin dhe atje -- s'e kam me  
15 vete.

16 Por nëse nuk do të ishte kjo fjali këtu, atëherë do  
17 shkonim tek dispozita 138 *default* dhe thotë nëse është e  
18 pranueshme sipas rregullës 138, rrjedhimisht është e  
19 pranueshme për vërtetësinë e përmbajtjes. E nuk do të kishte  
20 nevojë që të konkretizohet më tej në këtë fjali kjo pikë. Si  
21 ju thashë duhet të shikoj dhe rregulloren e mëparshme.

22 Po rregulla 138 është shumë e gjerë çka do të thotë që  
23 përfshinë çdo gjë, thotë çdo gjë që është relevante ka vlerë  
24 provuese, e kështu më tej. Prandaj dua një rregull edhe më  
25 konkrete. Nejse unë po e lë me kaq nuk po e shtjelloj më tej.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rregull.

2 Z. HALLING: [Përkthim] E admiroj kurajon e Mbrojtjes që  
3 guxon edhe kundërshton atë që kanë shkruar hartuesit e kësaj  
4 rregulloreje, ligjvënësit.

5 Unë doja të thoja këtë, deklaratat e mëhershme të një  
6 dëshmitari janë një kategori e caktuar provash në skemën  
7 statutore, prandaj ka dhe rregulla të posaçme që i trajtojnë  
8 këto siç është rregulla 154, 138, 153.

9 Pra, le të shohim rregullën 143(2)(c) ku flitet për  
10 pranueshmërinë e kësaj kategorie dokumentesh dhe për çdo gjë  
11 që është pjesë e kategorisë 143(2)(b) është i njëjti rregull  
12 që vlen për të gjitha dokumentet.

13 Nëse e ka interpretuar siç duhet Mbrojtja këtë, atëherë  
14 mund të pranohen deklaratat të mëhershme mospërputhëse sipas  
15 rregullores por asnjë material tjetër kur kundërshtohet  
16 besueshmëria e dëshmitarit. Dhe s'ka bazë racionale, as ka  
17 asnjë argument pse duhet të jetë kjo rregull.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë kam përgjigje, po mbase do të  
19 flasë Gjykatësi Mettraux.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Vazhdoni, z. Misetiç.  
21 Sepse unë kam diçka tjetër.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë i qëndroj qëndrimit tonë të  
23 mëhershëm sa i takon përkufizimit çfarë është një deklaratë e  
24 mëhershme mospërputhëse. Nëse do të na e kishit marrë parasysh  
25 ne qëndrimin tonë s'do ishim fare në këtë situatë dhe s'do

1 pranonim fare copa librash, copa artikujsh sepse këtu e kemi  
2 pikëpyetjen ne me interpretimin e rregullës 143(2)(c).

3 Tani unë nuk mendoj që po respektojmë përkufizimin strikt  
4 që ka dhënë Trupi Gjykses dhe të themi tani çdo gjë do të  
5 pranohet për shkak se ka një përkufizim që është bërë për  
6 këto. E di që kjo që thashë ishte shumë e vagullt, po tani po  
7 diskutojmë për interpretimin e përkufizimit të kufizuar të  
8 "deklaratave të dëshmitarëve" të cilin e ka bërë Trupi Gjykses  
9 dhe nuk mund të themi që ky ka qenë synimi dhe për këtë duhen  
10 pranuar.

11 Ky është qëndrimi im.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më thoni nëse mund të flas. Dua  
13 të them shkurtimisht diçka për parimin e parë, Prokuroria në  
14 fakt nuk po diskuton besueshmërinë e këtij dëshmitari. Ata po  
15 përdorin dëshmitarin si një mjet për të për t'i treguar copa  
16 videosh për të identifikuar persona dhe data.

17 Edhe pyetja e fabrikuar apo e qëllimshme që i bën atij që  
18 a i kishte parë ai raportet në mediat ndërkombëtare të bazuara  
19 këto në pretendimet e forcave serbe për krimet që mund të kenë  
20 ndodhur, që në fakt kanë ndodhur shpesh nga forcat serbe që  
21 kanë thënë dhe kanë fabrikuar prova dhe dëshmitari u tha jo,  
22 kjo në thelb cenon dëshminë e tij. Pra, ata nuk po e  
23 kundërshtojnë dëshmitarin dhe nuk duhet t'i kundërshtojnë  
24 dëshminë këtij dëshmitari. Prandaj këtu nuk po flasim fare për  
25 besueshmërinë e këtij dëshmitari.

1 Meqë ky dokument po thoni është i rëndësishëm për  
2 besueshmërinë, s'po jemi më të sigurt, nuk mund të vazhdoni të  
3 diskutoni besueshmërinë e këtij dëshmitari sepse në thelb nuk  
4 po diskutojmë besueshmërinë e këtij dëshmitari.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua të them diçka.

6 Rregulla 138. Rregulla 138 themi që duke lejuar, duke  
7 pranuar materialet ju cenoni të drejtat e të akuzuarve dhe në  
8 fakt zhbëhet vlera provuese në këtë rast. Ju po thoni se  
9 dëshmitari s'po tregon të vërtetën për një ngjarje. Por ama  
10 Prokuroria nuk e vërteton dot që ka ndodhur kjo ngjarje, por  
11 është mbështetur në një artikull gazete sepse kjo ngjarje nuk  
12 është fare e përmendur në aktakuzë. Ku e dini ju që kjo nuk  
13 është propagandë serbe, ky e dimë ne që kjo ka ndodhur në të  
14 vërtetë. Pra, vlera provuese këtu është shumë e zbehtë në këtë  
15 rast edhe Prokuroria po synon të baltos këta katër të akuzuar  
16 dhe të thotë që kanë qenë drejtpërdrejt të përfshirë në atë  
17 zonë.

18 Dhe është e padrejtë dhe për dëshmitarin në fakt a është  
19 ky i besueshëm apo jo, për këtë gjë është pikëpyetje sepse nuk  
20 e dimë a ka ndodhur vërtetë kjo ngjarje.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë kam një pyetje, z.  
22 Halling.

23 Qëllimi pse doni ju të pranohen këto artikuj, sepse  
24 vendimi që mori Trupi Gjykses ishte në fakt për një pyetje dhe  
25 jo për dokumentin në tërësinë e vet. Që të jem unë i qartë:

1 Këto dokumente ju po i paraqisni vetëm për qëllimin e  
2 besueshmërisë së këtij dëshmitari apo për qëllime më të gjera,  
3 përfshirë këtu, të paktën nga sa kam kuptuar unë nga  
4 parashtrimet tuaja, të vërtetoni atë që thatë ju, çfarë di i  
5 akuzuari për pretendimet për krimet që kanë ndodhur brenda  
6 rangjeve të UÇK-së?

7 Z. HALLING: [Përkthim] Qëllimi ynë është qëllim më i  
8 gjerë. E kuptojmë që vendimi që morët ju ishte që i pranojmë  
9 por vetëm për besueshmërinë, e thatë këtë më herët.

10 Po, ne mendojmë që kjo vlen edhe për besueshmërinë e  
11 dëshmitarit. Por ne do të donim që të pranojmë me sa më pak  
12 kufizime që të ishte i mundur ky material.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal, atëherë e  
15 kundërshtojmë të dyja argumentet që dha Prokurori.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Misetic, dua t'ju përgjigjem  
17 dhe unë për fjalinë e dytë të rregullës që thatë ka ndryshuar.  
18 Është ndryshuar. Keni të drejtë. Është ndryshuar në 2020.  
19 Versioni i 2017 nuk e ka pasur fjalinë e dytë.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Që të jem unë i qartë nga  
21 përgjigja e z. Halling, ishte e paqartë, ai tha: Ne duam të  
22 mbështetemi në këto artikuj gazete për faktin që kanë kryer  
23 këto krime? Sepse tani parashtrimi i tij nuk duhet të ketë  
24 asnjë lloj vlere.

25 Se kjo është absurde. Po këtu s'kemi fakte, si mundet të

1 merret një artikull në media dhe të përdoret si provë që ka  
2 ndodhur një ngjarje dhe bazuar në këtë artikull gazete të  
3 bëhet një lidhje me këta të akuzuar se kanë dalë në fotografi  
4 disa javë më përpara në të njëjtin vend, në një vend të  
5 ngjashëm.

6 Këtu nuk po flasim për metafizikë. Po ky është një proces  
7 komplet jo i logjikshëm nëse Prokuroria do vazhdojë në këtë  
8 mënyrë. Atëherë do kemi dhe një gjykim bazuar në copa  
9 gazetash.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Ajo që më tha Gjykatësi Mettraux  
11 nuk tha a ka njohuri i akuzuari për krimet që kanë ndodhur  
12 brenda rangjeve të UÇK-së, ishte diçka tjetër, nuk tha këtë z.  
13 Emmerson.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo, jo. Ishte e njëjta gjë sepse  
15 të kesh njohuri për krimet do të thotë që të kenë ndodhur  
16 krime. Po s'ka prova që kanë ndodhur krime për vërtetësinë e  
17 përmbajtjes. Kam frikë se z. Halling ka një pozicion këtu  
18 komplet të paqëndrueshëm dhe të paargumentueshëm.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni  
20 dëshmitarin.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Atëhere në qoftë se do ta ndihmoja  
22 Sekretarin do t'i jepja paraprakisht numrin e videos që do të  
23 transmetohet që është 061427-29 nga minuta e 15:06 deri në  
24 minutën 17:11. Nuk e di në qoftë se mund ta hapni tani.

25 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Videoja aktualisht është

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 144

1 e klasifikuar si konfidenciale. A mund të më thoni, të nderuar  
2 Gjykatës, në qoftë se mund ta transmetojë për publikun, apo  
3 jo?

4 Z. HALLING: [Përkthim] Sikurse e thashë edhe më herët, të  
5 gjitha pjesët e videos janë video të cilat mund të  
6 transmetohen për publikun.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund ta  
9 transmetoni.

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita,  
12 Dëshmitar. Ju kërkohet ndjesë për vonesën. Jemi gati për të  
13 vazhduar më tej.

14 Z. Halling, mund të vazhdoni me pyetjet.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit  
16 PY. Tani, do shohim një tjetër video që e keni filmuar ju,  
17 Dëshmitar, ndërkohë që Sekretari do ta vendosë në ekran. Dua  
18 që të kalojmë së bashku disa prej ngjarjeve që keni përshkruar  
19 në faqet nga 278 deri në 279 të librit tuaj ku flisni për  
20 filmimin e Sahit Jasharit në Likovc.

21 Pyetja e parë është kjo: Kush është Sahit Jashari,  
22 Dëshmitar?

23 PË. Sahit Jashari ka qenë një ndër luftëtarët e radhëve të  
24 para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në komandën e  
25 komandantit legjendar Adem Jashari.



1 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem zmadhojeni videon,  
2 Sekretar, që të shikojmë të tërën.

3 PY. Atëherë kemi këtë makinën që është në ekran me targë Pu-  
4 101-A, a mund të na thoni se nga ku e keni marrë, ku është  
5 filmuar ky fragment?

6 PË. Ky është filmuar në Likovc të Drenicës ku ka qenë shtabi  
7 i zonës operative të Drenicës.

8 PY. Kur e keni filmuar këtë pjesë?

9 PË. Kjo duket në qershor 1998.

10 PY. Çfarë pozicioni, çfarë posti ka pas Sahit Jahsari në  
11 Likovc, çfarë roli ka pas ai?

12 PË. Aty flitej se ishte komandant i policisë ushtarake të  
13 zonës operative të Drenicës. Un s'kam pa ndonjë vendim me  
14 shkrim për këtë, por ashtu flitej në mesin e ushtarëve.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që ta  
16 transmetojë këtë video deri në 01:07.

17 [Luhet videoincizimi]

18 Z. HALLING: [Përkthim]

19 PY. Dëshmitar, zotëria që doli nga vetura e zezë kush ishte  
20 ky person?

21 PË. Ishte Sahit Jashari.

22 PY. Dhe çfarë është kjo godina, kjo ndërtesa ku po futet ai,  
23 çfarë është, çfarë godine është?

24 PË. Me siguri ka qëndru këtu luftëtarët e UÇK-së. Nuk e di  
25 unë. S'kam hi, s'kam qenë brenda asnjëherë.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit tani që të  
2 paraqesë dokumentin 061427-16, është sërish një video dhe do i  
3 kërkoja që të shkoi në minutën e 21:14.

4 PY. Dëshmitar, a e keni përdorur ju ndonjë prej filmimeve që  
5 keni bërë të Sahit Jasharit në Likovc në korrik të 1998 a i  
6 keni përdorur ato si dokumentarë që keni shkruar pastaj për  
7 dokumentimin e librit tuaj, domethënë, këto filmime a i keni  
8 përdorur si bazë për shkrimin e librit, Dëshmitar?

9 PË. Po, i kam përmend në libër.

10 PY. Me çfarë kuptoj një transmetim është bërë më datën 17 dhe  
11 një më 18 korrik, e kam fjalën për dokumentarin. Në cilin  
12 dokumentar mendoni që është transmetuar kjo pjesë e filmimit  
13 tuaj në Likovc?

14 PË. Kjo transmetuar në dokumentarin që është kushtuar  
15 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i cili është transmetuar në  
16 televizionin shqiptar më 18 korrik 1998.

17 PY. Faleminderit.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë kalojmë tek videoja. Në  
19 qoftë se do të shikojmë minutën 21:14, shohim Sahit Jasharin,  
20 është më e thjeshtë që të ndjekim çka do thotë ai në këtë  
21 version. Kështu që do i kërkoj Sekretarit që të bëjë  
22 transmetimin e videos deri në 21:30, pra, minuta 21 sekonda 30  
23 nga aty ku është.

24 [Luhet videoincizimi]

25 DËSHMITARI: Nuk ka zë në gjuhën shqipe.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe unë të njëjtën gjë vura re. Do  
2 i lutesha Sekretarit që ta transmetojë me zë.

3 [Trupi Gjykues dhe Sekretari i Gjykatës  
4 këshillohen]

5 Z. HALLING: [Përkthim] Në rregull. Në fakt ka zë,  
6 domethënë, është me audio në versionin që kemi përfshirë në  
7 dokumentet për palët, gjithsesi mund t'jua them unë tekstin  
8 PY. Sahit Jashari thotë:

9 "Policia ushtarake e UÇK-së janë profesionalisht të  
10 përgatitur dhe janë të gatshëm që të kryejnë dhe të realizojnë  
11 urdhra të dhënë nga Shtabi Përgjithshëm i Kosovës".

12 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të vazhdojmë, mund të  
13 transmetohet videoja, domethënë, edhe një herë nga 20:35 deri  
14 në 20:57.

15 [Luhet videoincizimi]

16 Z. HALLING: [Përkthim]  
17 PY. Atëherë do transmetohet kjo pjesa dhe do ju pyes pastaj  
18 për këtë ndërtesën nga ku do të dalë një grua.

19 [Luhet videoincizimi]

20 DËSHMITARI: Edhe kjo nuk ka zë.

21 Z. HALLING: [Përkthim]

22 PY. E kuptoj. Megjithatë pyetja ime ka të bëjë vetëm me  
23 godinën, me ndërtesën. Kjo gruaja që del nga kjo ndërtesa  
24 identifikohet si Irfete Spahiu, po çfarë godine, çfarë  
25 ndërtese është kjo, mund të na e thoni?

1 PY. Kjo është eprorja e UÇK-së Irfete Spahiu e cila del nga  
2 ndërtesa e shtabit operativ të zonës operative të Drenicës.  
3 Nuk ka qenë Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së si shpesh dikush i  
4 ngatërron, po ka qenë shtabi i zonës operative të Drenicës.

5 PY. Kjo është në Likovc, apo jo?

6 PË. Po, në Likovc, po.

7 PY. Atëherë për t'i dhënë përgjigje pyetjes sime kjo është në  
8 Likovc, e thoni dhe një herë përgjigjen Dëshmitar?

9 PË. Po, është në Likovc të komunës së Skënderajt në Drenicë.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë do transmetojmë dhe pesë  
11 sekonda të tjera të kësaj videoje nga 22:53 deri në minutën  
12 24.

13 [Luhet videoincizimi]

14 Z. HALLING: [Përkthim] Deri tek minuta 23 në fakt.

15 [Luhet videoincizimi]

16 Z. HALLING: [Përkthim]

17 PY. Edhe kjo pjesë është marrë nga dokumentari i 18 korrikut  
18 1998, është e saktë kjo, Dëshmitar?

19 PË. Po.

20 PY. Me ç'kuptoju unë ju nuk i njihni zotërinjtë në të djathtë  
21 të ekranit, megjithatë duke filluar nga e majta e fotografisë  
22 deri në të djathtën identifikoni ata njerëz, ata persona që ju  
23 njihni, Dëshmitar.

24 PË. Po nga e majta i pari është Isuf Gashi, komandant Baca,  
25 pastaj është gjeneral Shaban Shala, heroi i Kosovës, pastaj

1 është Xhemë Gashi, Gjermani dhe ky në mes që flet është Bedri  
2 Zyberaj. Këta të tretë nuk i njoh. Kështu si figura po më  
3 kujtohen, po emrat nuk ua di.

4 PY. A ju kujtohet pak a shumë kur është bërë ky filmimi dhe  
5 në çfarë zone është bërë filmimi?

6 PË. Është bërë në qershor të vitit 1998. Datën e saktë nuk e  
7 di, se nuk e kam thënë as në libër. Si kam thënë më herët nuk  
8 kam mbajtur ditar dhe nuk i kam ditur saktë datat. Është  
9 transmetuar në dokumentarin kushtuar Ushtrisë Çlirimtare të  
10 Kosovës që u transmetua në televizionin shqiptar më 18 korrik  
11 1998.

12 PY. Në çfarë vendi? Ku?

13 PË. A në fshatin Drenoc, shkrun këtu shumë mirë tabela.  
14 Shkolla fillore, Vëllezërit Frashëri, Drenoc të komunës së  
15 Rahovecit.

16 PY. Faleminderit. Dëshmitar, këto dokumentarët më datë 18  
17 dhe 19 korrik të 1998, ju shkruani në librin tuaj që Hashim  
18 Thaçi i ka parë këto filmimi përpara sesa të transmetoheshin.  
19 E shkruani këtë në faqen 295 dhe 294 të librit. A është e  
20 saktë kjo, Dëshmitar?

21 PË. Po, e saktë është. Kjo është ideja ime, kërkesa ime, që  
22 meqenëse unë kisha punu një kohë të gjatë në televizionin e  
23 Prishtinës si gazetar po nuk kisha -- hera e parë që përcillja  
24 zhvillimet luftarake dhe në rrethana krejtësisht tjera. Dhe  
25 dëshiroja që për hir të opinionit që të mos më shpëtoj ndonjë

1 gabim ose ndonjë imazh që nuk përkon me afirmimin e Ushtrisë  
2 Çlirimtare të Kosovës, sepse si gazetar i pavarur dëshiroja që  
3 Ushtria Çlirimtare e Kosovë të dalë para opinionit si një  
4 ushtri sa më serioze dhe të ketë një mbështetje më të fuqishme  
5 nga mbarë populli shqiptar. Do të thotë, ka qenë kërkesë e  
6 imja, jo kërkesë e z. Thaçi.

7 Sepse si kam thënë dhe në libër edhe të gjithë edhe para  
8 në bashkëbisedim me ju, unë kam qenë gazetar i pavarur. Dhe  
9 nuk kam lejuar askush që të më përzihet me punën time  
10 profesionale. I kam pranuar sugjerimet, idetë, kemi biseduar  
11 sesi, por kurrsesi nuk kam pranuar që të ketë censurë dikush  
12 tjetër të më diktoj se çka të transmetoj e çka të mos të  
13 transmetoj. Për çdo gjë e mbaj përgjegjësinë unë.

14 PY. E kuptoj, Dëshmitar. Versione të dokumentarit të datës 17  
15 dhe të 18 korrik, pra, kanë qenë identike?

16 PË. Po.

17 PY. Domethënë, versioni që ka parë Hashim Thaçi, versionet që  
18 ka parë Hashim Thaçi me ato që janë transmetuar kanë qenë  
19 identike?

20 PË. Identike. Pa asnjë ndryshim. Ashtu si i kam montuar në  
21 Prishtinë, i kam dërguar në Tiranë dhe janë transmetuar pa  
22 asnjë ndryshim.

23 PY. Ne librin që ke shkruar thua që Hashim Thaçi ishte i  
24 kënaqur me dokumentarët, kështu, të paktën ky është formulimi  
25 që keni dhënë në librin tuaj, është e vërtetë?

1 PË. Ashtu kam shkruar dhe ashtu besoj që është.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dokumentari i  
3 datës 17 korrik është në prova të regjistruara gjyqësore dhe  
4 ka numrin P01260. Ndërkohë që dokumentari i datës 18 korrik  
5 është pranuar si prova P940. I vetmi dokument në këtë linjë  
6 pyetjesh që kërkojmë që të pranohet është fragmenti ku  
7 paraqitet Sahit Jashari dhe ky ka numrin 061427-29. Kërkojmë  
8 që të regjistrohet si provë vetëm segmenti që është nga 15:06  
9 deri në 17:11.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë  
11 kundërshtim nga palët?

12 PËRKTHYESJA: Palët nuk kanë kundërshtim.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
14 Dokumenti 061427-29 pranohet.

15 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
16 merr numrin e provës material P01282. Në qoftë se e kuptova  
17 drejtë, e keni fjalën vetëm për atë fragmentin që përmendi  
18 Prokurori, apo jo?

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Nga 15:06  
20 deri në 17:11.

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Aktualisht  
22 është dokument konfidencial në *Legal Workflow* por me ç'kuptoj  
23 duhet riklasifikuar si publik, apo jo?

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Në rregull

1 PY. Tani, Dëshmitar, dua t'ju pyes lidhur me diçka që keni  
2 shkruar në faqen 236 të librit tuaj, mbase është mirë që t'jua  
3 lexoj. Ju thoni:

4 "Në takimet me kolegët e mi gazetarë dhe me një komandant  
5 'Presheva'

6 "Në Likovc me Tahir Deskun, me kolegun tim që ishte  
7 gazetar në Televizionin Prishtina. Ishte kënaqësi që e shikova  
8 atë, e pashë atë. Ai ishte i këndshëm në biseda. U takova me  
9 të së bashku me një gazetar norvegjez i cili ishte plagosur në  
10 kufi, emrin ky e kishte Paul Refsdal ..."

11 Pyetja ime e parë është kjo: Nga e mësuat juve, nga i  
12 mësuat këto gjëra që lidhen me gazetarin norvegjez Paul  
13 Refsdal që thoni ju? Nga e mësuat që ai ishte plagosur në kufi  
14 dhe ishte kyçur pastaj në UÇK, nga i morët vesh këto  
15 informacione?

16 PË. Po Tahir Desku, kolegu Tahir Desku më informoi dhe kam  
17 pas një takim shumë të shkurtër me të. Nuk di asgjë më tepër.  
18 As ku është plagosur. Po pas luftës kam marrë vesh që është  
19 plagosur.

20 PY. Ndoshta do ishte mirë që ta përfundoj citimin se e lashë  
21 përgjysmë. Në fjali thuhet që:

22 "E takova më pas me një gazetar norvegjez që ishte  
23 plagosur në kufi dhe që kishte lënë jetën e tij të rehatshme  
24 në Norvegji për të ardhur në Kosovë".

25 Dëshmitar, unë e kuptoj që ju nuk e dini që Paul Refsdal



Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 153

1 ka shkruar një libër rreth përvojës dhe kohës që ka shpenzuar  
2 në Kosovë, a është e vërtet kjo, Dëshmitar?

3 PË. Jo, nuk e di.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të  
5 paraqesë në ekran tani dokumentin SPOE00209434 deri në  
6 SPOE00209512. Dokumenti në origjinal është gjuhën norvegjeze,  
7 por do kërkoja që të paraqitet përkthimi i këtij dokumenti në  
8 shqip dhe përkthimi po ashtu në anglisht përbri njëri-tjetrit.  
9 Jam i interesuar tek faqja SPOE00209444 për momentin.

10 PY. Do t'ju lexoj një pjesë, Dëshmitar, të asaj çfarë ka  
11 shkruar Paul Refsdal në librin e vet dhe pastaj do t'ju bëj  
12 një pyetje lidhur me të.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë sapo të paraqitet dhe  
14 dokumenti në anglisht, mund ta orientoj Sekretarin. Atëherë  
15 faqja është SPOE00209444. Atëherë fillon me "Rezidenca Refsdal  
16 ..."

17 PY. Këtë thotë gazetari:

18 "'Rezidenca Refsdal, urdhëroni' përgjigjet nëna ime.

19 "'Alo, jam unë'.

20 "'Pal ku je?' pyet ajo pa treguar shqetësim në zyrën e  
21 vet. 'Ku je?'

22 "'Në Kosovë'.

23 "'Si po ja çon?

24 "'Jo, shumë mirë' i them 'jam plagosur' i them por  
25 pendohem në atë moment. Dhe shtoj se jam jashtë rreziku dhe do

1 më operojnë, mbase nesër në mëngjes dhe nuk do të kem plagë  
2 dhe pasoja të tjera për jetën. Sa më shumë flas aq më shumë më  
3 merret fryma dhe më duhet të marr frymë në mes të fjalive. Kjo  
4 më irriton tani që përpiqem që të qetësojë nënën time.

5 "Jam kameraman pa kamera dhe jam ilegalisht në Kosovë."

6 Kjo përkon me atë që të ka thanë Tahir Desku lidhur me  
7 Paul Refsdal, apo jo, Dëshmitar?

8 PË. Tahir Deku më ka thënë vetëm më ka thënë është gazetar  
9 nga Norvegjia më asgjë më tepër. Thashë kam marrë vesh ma vonë  
10 mbas luftës që ai ka qenë i plagosur, po nuk di ma tepër  
11 kurrgjë për të. Dhe nuk mund ta komentoj atë ditarin e tij,  
12 librin e tij. Dhe nuk mbaj përgjegjësi për atë.

13 PY. Do kalojmë dy faqe të tjera.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Për Sekretarin është dokumenti  
15 SPOE00209450

16 PY. Dëshmitar, kush është komandanti i UÇK-së që njifet me  
17 nofkën Luli gjatë luftës?

18 PË. Po, komandant Luli është Kadri Veseli.

19 PY. Refsdal shkruan si ë poshtë, është në fillim fare të  
20 faqes:

21 "Personi, burri me veshje të shtrenjta ulet pranë meje  
22 dhe më kujdes pastron fytyrën. Në gjermanisht më shpjegon se  
23 është nga UÇK-ja dhe ka ardhur të hetojë çfarë kishte ndodhur  
24 në Pashtrik. I shpjegova për pritën, për granatën e dorës dhe  
25 plagët që kisha marrë.

1           "‘Emri im është Luli’ më thotë ai. ‘Çdo njeri e di kush  
2 jam unë. Pas pak ditësh këto do të çojnë në spital më të  
3 mirë’."

4           Z. HALLING: [Përkthim] Dhe tani në fund fare dua që t’i  
5 kërkoj Sekretarit që të kalojmë në dokumentin SPOE00209471.  
6 Fundi i kësaj faqeje dhe pastaj do kalojmë tek faqja  
7 pasardhëse që përfundon me 472.

8           Këtu ai flet për mesin e shtatorit të vitit 1998 dhe  
9 pastaj në qoftë se do të kalojmë tek faqja tjetër, Refsdal  
10 shkruan si më poshtë:

11           "E kuptova që vendi ku qëndroja, salloni ku unë po flija  
12 ishte qendra e komandës së asaj çfarë ka mbetur nga ëndrra e  
13 shqiptarëve për pavarësi. Të gjithë aktorët kryesorë të  
14 Drenicës janë këtu. Sulltani, shefi i zbulimit Djopa,  
15 komandant brigade Kapushi, shefi i policisë dhe natyrisht edhe  
16 Gjarpri".

17           Edhe një tjetër pjesë do të doja që të shikonit nga ky  
18 libër, Dëshmitar, për referencë është nga SPOE00147148.

19           Nga përgjigjet që na keni dhënë më herët, unë e kuptoj që  
20 ju nuk e keni idenë, nuk është se jeni njohur me atë çfarë  
21 përshkruan z. Refsdal --

22 PË. Hera e parë po e shikoj këtu, për herë të parë. Edhe të  
23 lutem mos më ngarko me këto, se ka dhe gabime mjaft edhe në  
24 emra aty dhe në pseudonime ka. Plot gabime paska.

25 PY. Do kalojmë gjithsesi për pak në këtë dokument, megjithatë

1 le të shikojmë edhe diçka tjetër përpara sesa të vazhdojmë.

2 Atëhere këtë fotografinë që e shikoni këtu e keni parë  
3 për herë të parë në seancën përgatitore që patëm bashkë  
4 përpara një jave, kështu?

5 PË. Po. Po, e kam pa.

6 PY. Kush është zotëria qepo e nget motorin, personi i parë?

7 PË. Është komandant Sahit Jashari. Dhe pas tij është  
8 luftëtari Muharrem Xhemajli. Ashtu po më duket mu.

9 PY. Ku mendoni ju se është bërë kjo fotografi në qoftë se e  
10 dini?

11 PË. Më duket sipas prapavijës duhet të jetë në Likovc të  
12 Drenicës.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, Paul Refsdal  
14 flet se është takuar me shefin e policisë në librin e vet. Kjo  
15 është një fotografi që është marrë prej tij dhe është marrë  
16 nga arkivi kombëtar i Kosovës dhe i është dhënë ZPS-së. Duke e  
17 marrë parasysh identifikimin e dëshmitarit të personave në  
18 fotografi, do kërkonim që të pranohej kjo fotografi në prova.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë  
20 kundërshtim?

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Nga e dimë që është bërë prej tij?

22 DËSHMITARI: Nuk është fotografi e ime. Kush? Më fal. Të  
23 lutem, në qoftë se keni deklaru se është fotografi që kam bërë  
24 unë, nuk e kam bërë unë. As kameramani im s'e ka bë këtë  
25 fotografi. Ta sqarojmë për opinionin se nuk ë fotografi e imja

1 e as e kameramanit tim. Ku e keni marrë ju e dini.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

3 E kuptoj që ky është një informacion i cili na është  
4 dhënë neve nga arkivi kombëtar i Kosovës. Na e kanë dhënë ata  
5 këtë fotografi.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtoj për themelësinë.  
7 Mënyra sesi u ofrua fotografia ishte e tillë sikur mu duk  
8 sikur jua kishte dhënë Paul Refsdal dhe kështu që nuk është  
9 autentike.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë kundërshtoj për shkaqe  
11 relevance.

12 Z. TULLY: [Përkthim] Edhe unë e kundërshtoj për shkak  
13 relevance.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Ne jemi munduar që të pranojmë  
15 kapitullin përkatës të Paul Refsdal si provë jogojore, por na  
16 u tha që nuk ka kontekst të mjaftueshëm për të për të pranuar.

17 Gjithsesi do të flasim më tepër sot dhe nesër për këtë  
18 libër për të treguar që ka pjesë të librit të këtij gazetari  
19 që përkojnë me zhvillimet e asaj kohe. Pavarësisht se z.  
20 Bytyqi, e thotë që nuk është në dijeni të përmbajtjeve të  
21 këtij libri ose që ekziston ky libër, megjithëse nuk kemi  
22 arsye për ta vënë këtë në pikëpyetje, gjithsesi ne e ofrojmë  
23 përmbajtjen e këtij libri për më tepër kontekst, nuk kërkojmë  
24 që të pranohet në provë libri tani.

25 Por thjesht po kërkojmë këtë fotografi që të pranohet si

1 provë. Mbase më vonë mund të kërkojmë pranimin e librit më  
2 tej.

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] Është një mjet për të justifikuar  
4 paaftësinë e themelësisë së dokumentit.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë do shtoja që nuk shikoj një  
6 shpjegim sa i takon pyetjes që bëri Gjykatësi, që çfarë  
7 relevance ka fotografia, nuk morëm përgjigje.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Z. Refsdal thotë që e ka parë  
9 shefin e policisë së UÇK-së në librin e vet. Ka bërë një  
10 fotografi të dëshmitarit dhe dëshmitari në fakt e identifikoi  
11 Sahit Jasharin dhe Sahit Jashari ka qenë shef i policisë së  
12 zonës së Drenicës.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Po nuk është relevante fare, se  
14 nuk e dimë fare në qoftë se e ka bërë apo jo Paul Refsdal këtë  
15 fotografi apo jo.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo vetëm kaq, por edhe përshkrimi  
17 i librit, përshkrimi që i është bërë në libër për shefin e  
18 policisë nuk përkon me përshkrimin e personit që shohim në  
19 fotografi.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do i caktojmë  
21 një numër provizor prove.

22 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar  
23 Gjykatës. Dokumenti SPOE07408-0011748 do marrë një numër të  
24 përkohshëm të provës materiale, që është P01283. Aktualisht  
25 është i klasifikuar si konfidencial.

1 DËSHMITARI: Z. Kryetar i Gjykatës.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
3 vazhdoni.

4 DËSHMITARI: Të lutem. Deshta të sqaroj sepse z. Prokuror  
5 u mundua që këtu të mos të më besoj mu.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dëshmitar.

7 DËSHMITARI: Unë jam betuar në fillim të këtij procesi --

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndaloni, ju  
9 lutem. E fika mikrofonin tuaj.

10 Të lutem ndalo së foluri, prisni derisa t'ju japim leje  
11 dhe sa t'ju autorizojmë që të filloni të flisni. Tani nuk jua  
12 kemi dhënë kohën për të folur. Kemi vetëm dy minuta që na kanë  
13 ngelur. Prokurori mund të ketë disa pyetje tjera dhe do ta  
14 mbyllim këtu për sot.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Po kemi dhe dy video  
16 të shkurtra dhe pastaj do ta mbyllim për sot.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju kërkoh ndjesë z.  
18 Prokuror, po na duhet diçka që ta sqarojmë, një çështje që ka  
19 nevojë për sqarim ose transkripti në faqen 138 në përgjigje të  
20 pyetjes tuaj që kush ishte komandanti që njëhej me nofkën  
21 komandanti Luli gjatë luftës? Përgjigja është:

22 "Po, komandant Luli është Sali Veseli", thotë  
23 transkripti. Për ta sqaruar.

24 Z. HALLING: [Përkthim]

25 PY. Ne e kemi këtu në procesverbal që komandant Luli është

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 160

1 Sali Veseli, kështu thatë Dëshmitar?

2 PË. Jo, nuk thashë Sali Veseli. Gabim. Të lutem dua ta  
3 konfirmoj se Librin e kolegut norvegjez por nuk e kam lexuar e  
4 kam deklaruar dhe në intervistën me ju edhe tani të thashë dy-  
5 tri herë. Kjo është e vërtet, jam betuar se do ta them të  
6 vërtetën dhe kjo është e vërteta se s'e kam lexuar, nuk di për  
7 atë ngjarje.

8 PY. Dëshmitar, këtë e kuptojmë.

9 PË. Dua të them se mund të ketë pas në Ushtrinë Çlirimtare të  
10 Kosovës edhe ndonjë luftëtar që e ka pas pseudonimin Luli,  
11 mund të ketë, siç thashë ka pas Daja, ka pas edhe pseudonime  
12 tjera të ngjashme, disa vetë i kanë pas. Për atë nuk duhet të  
13 për atë të konfirmoj se pikërisht flitet për Kadri Veselin  
14 këtu. Nuk e di unë saktë. Për atë më ka shkruar kolegu  
15 norvegjez. Pyetni atë.

16 PY. A njihej ndryshe Kadri Veseli si komandant Luli,  
17 Dëshmitar?

18 PË. Njihej, po. Po mund të ketë edhe ndonjë Lul tjetër. Unë  
19 s'po di tash në çfarë konteksti ka shkruar kolegu norvegjez,  
20 për kën e ka pas fjalën ai.

21 PY. E kuptoj që mund të ketë pas edhe Lula të tjerë, por a  
22 njihni ju ndonjë komandant tjetër të UÇK-së që ka pas të  
23 njëjtën nofkë, Dëshmitar?

24 PË. Unë nuk e njof. S'e di.

25 PY. Faleminderit.



Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Halling

Faqe 161

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi thujse  
2 drejt fundit të ditës.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Po, mund ta vazhdojmë nesër, mund  
4 ta ndërpresim këtu sonte.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
6 kemi përfunduar sot. Do të duhet të ktheheni nesër ë orën 9.00  
7 të mëngjesit. Nuk duhet të flisni me askënd për dëshminë e  
8 dhënë përpara Trupit Gjykses. Nëse dikush mundohet të  
9 kontaktojë me ju, duhet të na e raportoni menjëherë këtë gjë.  
10 Tani mund të dilni nga salla së bashku me Asistenten.

11 Faleminderit që ishit me ne sot, Dëshmitar.

12 DËSHMITARI: Faleminderit edhe juve.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk e di nëse mund të pyes  
14 diçka Prokurorin?

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] sa i takon provës P1628  
17 është një regjistrim në video e Hashim Thaçi që është pjesë e  
18 dokumentarit të Agim Qelaj. Data e këtyre komenteve nuk është  
19 e qartë për sa i takon procesverbalit. Kështu që do ishte mirë  
20 që nesër ta sqaronim me dëshmitarin se për çfarë datash bëhet  
21 fjalë kur është filmuar dokumentari.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Po, besoj që dëshmitari tha që  
23 dokumentari është botuar rreth vitit 2009, megjithatë do ta  
24 pyes nesër në fillim të seancës.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Jo, jo nuk po flas për datën

1 e botimit, po flas për datën kur ka fol Thaçi.

2 Z. HALLING: [Përkthim] E kuptoj.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa kohë ju  
4 duhet nesër?

5 Z. HALLING: [Përkthim] Mendoj që do përfundoj në seancën  
6 e parë. Po i ndjek pyetjet në mënyrë kronologjike dhe  
7 padiskutim që qershori i 1998 është periudha më, domethënë,  
8 për këtë periudhë e kam pjesën dërrmuese të pyetjeve. Mendoj  
9 se do përfundoj gjatë seancës së parë. Megjithatë më duket  
10 sikur po shkon pak më ngadalë sesa planifikimi paraprak për  
11 pyetjet kryesisht të këtij dëshmitari.

12 Dua që Zyra Administrative të më thotë sesa kohë kam  
13 përdorur deri tani, megjithatë planifikoj që nga seanca e parë  
14 nesër të përfundojmë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 Ka ndonjë palë tjetër ndonjë gjë për të thënë?

17 Meqë s'keni gjë tjetër për të thënë do ta mbyllim këtu  
18 sot.

19 Përfundojmë këtu dhe e nisim përsëri seancën nesër në  
20 9.00 të mëngjesit.

21 --- Seanca mbyllet në orën 16.30

22

23

24

25